

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7685 E diel 21 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

30 vjet më parë, më 22 tetor 1988 u nënshkrua marrëveshja qeveritare midis Shqipërisë dhe Gjermanisë Federale mbi Bashkëpunimin Ekonomik dhe ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Në një jubile të veçantë shqiptaro - gjerman



Dje

në "Deutsche Welle"

Nga BARBARA WESEL

Në javët e ardhshme do të merret vendimi se cilët do të jenë kandidatët kryesorë të familjeve partiake evropiane për zgjedhjet për Europën. Megjithatë ...
Vijon në faqen 22

Komisioni i BE: Përgatitje për zgjedhjet europiane



Lushaj: Djali s'është pjesë e grupit kriminal

Sali Lushaj: Ja pse djali im, Stresi ka komunikuar me Bajrët në Shkodër

"Stresi ka qenë në Shkodër për koncert, mund të ketë komunikuar me Bajrët për këtë arsye

TIRANË. "Djali ka shkuar 3-4 herë në Shkodër për koncert dhe ka ndërjetësuar në disa lokale. Mund të jetë i vërtetë komunikimi me Bajrët, por është bërë për këtë qëllim. Pastaj të kërkosh ndihmë të dalësh jashtë nuk është veprë penale" Kështu është shprehur dje në studion e emisionit "Kjo Javë" në "News 24", Sali Lushaj ...
Në faqen 7

PREKEN ISHUJT E SARANDES NGA 12 MILJET GREKE? MPJ: E VERTETA E MARREVESHJES

KOTZIAS: UJERAT TONA, ZGJEROHEN 12 MILJË

Ish-ministri i Jashtëm: "Zgjerimi në krahun perëndimor, nga 6 në 12 milje detare. Dekretet presidenciale janë gati"



(Në foto) Ish-ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias

FONDET GREKE

Idrizi: Skandal kombëtar, Bushati: Nacionalizëm për tepsi. PDIU: Të zbardhen përfituesit
Në faqen 2

LABORATORI I DROGES

"Policia na terrorizoi, në shtëpi mbetën e moshuara e paralizuar dhe 2 fëmijë të mitur"
Në faqen 6

ATENTATI

Qëllohet me breshëri plumbash makina e aktivistit të PD-së, Pjerin Kaçi
Në faqen 7

DESHMITE

Rrëfimet e të mbijetuarve të komunizmit në një botim
Në faqen 11

REAGIMI PAS AKUZAVE



Gjyqtari Gjin Gjoni, përgjigje ministres: Leja prindërore, sipas ligjit në fuqi
Në faqen 10



Kënga për Princ Gjergj Aranit Komnen Golemin, Zotin e Çermenikës, Mokrës dhe Sapatit

"Kanga e Gjorq Golemit, Princit të Sopotit"

"Lutja" e Gazmend Lekës, një grishje për lutje e gjithë shoqërisë

NGA AVNI ALCANI

Në vitin 1938 zoti Shahin Zharri (1915-1991) nga Bërzeshta e Librazhdit, botoi në revistën "Shkolla Kombtare" (Nr. 16-17, faqe 22) këngën historike me titull: "Kanga e Gjorq Golemit, Princit të Sopotit".1) e cila i kushtohet një prej figurave



më të shquara historike të shekullit të 15-të, Princit Gjergj Aranit Komnen Golemi, Zotit të Çermenikës, Mokrës dhe Sapatit.2) Shahin Zharri, ende nxënës në klasën e shtatë të shkollës Normale të Elbasanit, mblodhi në fshatin e tij të lindjes ...
Suplement

SKANDALI I FINANCIEMEVE REAGIMET

Financimi i mediave në Shqipëri, kreu i PDIU: Meta të mbledhë Këshillin e Sigurisë

Valentina Madani

Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi e cilësoi dje skandal kombëtar financimin e portaleve dhe gazetarëve në Shqipëri nga shteti grek. Duke e konsideruar si emergjencë kombëtare, Idrizi kërkoi dje zbardhjen e të vërtetës së përdorimit të fondeve "sekrete" greke në Shqipëri për të ndikuar në opinionin publik. Idrizi i bëri thirrje Presidentit të Republikës që të kërkojë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare me anë të cilit të zbulojë të vërtetën e përdorimit të parave të 'zeza' greke në Shqipëri. Kreu i PDIU-së, e ka quajtur si mjaft shqetësuese që Greqia ka dhënë vetëm në një muaj 1 milion euro. Ndaj ai kërkoi që të zbulohet sa janë shifrat reale dhe kush janë përfituesit e këtyre fondeve. "Në këto kushte: I kërkojmë presidentit të mbledhë urgjentisht Këshillin e Sigurisë Kombëtare, të vërë në lëvizje të gjitha agjencitë ligjzbatuese për të hetuar e vënë prapa dyerve të qelisë ata që kanë marrë para, shumat e qëllimet, sepse vetëm në një muaj bëhet fjalë për 1 milion euro. Po me vite sa është kjo shumë? I bëj thirrje Presidentit të kërkojë urgjentisht mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, e të kërkojë informacionet e nevojshme për të kuptuar sasinë e vërtetë të fondeve të zeza sekrete të dhëna nga Ministria e Jashtme greke, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimet Sekrete Greke dhe qëllimin dhe ndikimin real, që kanë pasur këto fonde në manipulimin e opinionit publik dhe vendimmarrjen e shtetareve shqiptarë. Ritheksoj që janë 1 milionë euro vetëm për një muaj, e asnjëherë nuk do kuptojmë sasinë e vërtetë të fondeve të paligjshme të derdhura në vend, nëse nuk shtrihet si një prioritet për sigurinë kombëtare. I kërkojmë urgjentisht Prokurorisë së Përgjithshme të hetojë, cilat janë portalet, gazetat, televizionet, gazetarët, biznesmenët, OJQ-të, që janë financuar nga Fondet e Zeza sekrete të Ministrisë së Jashtme greke, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shërbimit Inteligent Grek", u shpreh kreu i PDIU-së Shpëtim Idrizi.

REAGIMI

Pas akuzave të forta të Shpëtim Idrizit në adresë të ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati, ky i fundit i është përgjigjur nëpërmjet rrjetit social Twitter. Bushati e quajti si përpjekje të dëshpëruar për t'u faktorizuar qëndrimin e Idrizit dhe

Fondet greke, Idrizi: Skandal kombëtar, Bushati: Nacionalizëm për teps

PDIU: Të zbardhen përfituesit në media e OJQ

DITMIR BUSHATI

"Kush bërtet i dëshpëruar për t'u faktorizuar në hartën e nacionalizmit ballkanik, s'ka lidhje me çështjen kombëtare e as me vendosmërinë e qeverisë "Rama" që përfshiu në bisedime me fqinj jugor të gjitha çështjet që i kishte mbuluar pluhuri i harresës #nacionalizëmper teps", - shkruan ministri Bushati në Twitter.



Kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi

SHPËTIM IDRIZI

"1 milion euro fonde të zeza vetëm për muajin e fundit, me të cilat shteti fqinj ka blerë media e portale shqiptare duke i paraqitur tezat progreke si mendime të paanshme. Qëllimi i këtyre fondeve ishte të vazhdojë të demtojë moralisht çështjet tona kombëtare, të manipulojë marrëveshjen e detit, të varrosë çështjen çame e të vazhdojë diskriminimin ndaj shqiptarëve të Çamërisë", deklaroi z. Idrizi.

'Idrizi të dorëhiqet', shoqata 'Çamëria' përgënjeshtron Dash Tahirin

Kalimi i PDIU-së në koalicion me PD-në ka sjellë reagime të ashpër të kundërshtarëve të tij brenda çamëve. Ish-deputeti i kësaj partie që kaloi i pari në krah të Lulzim Bashes, Dashamir Tahiri i kërkoi dje nga Vlorë, dorëheqjen e Shpëtim Idrizit nga drejtimi i partisë. Tahiri e akuzon atë se ka vendosur pushtetin mbi interesat e qytetarëve çam. Por pas deklarimit të ish-deputetit të PD-së Dashamir Tahiri, se Shpëtim Idrizi duhej të dorëhiqet nga drejtimi i PDIU-së, vjen një reagim nga shoqata 'Çamëria'. Përmes një deklaratë shoqata 'Çamëria' theksoi se në Vlorë nuk ka shoqatë tjetër me këtë emër, por sipas saj ka 1 në të gjithë Shqipërinë. Sipas kësaj shoqate, të gjitha takimet të cilat bien ndesh me amanetin për çështjen 'Çame', janë të papranueshme.

kërkesën e tij për të bërë transparencë për financimet e errëta greke në Shqipëri. Për ministrin e Jashtëm çështja e financimit sekret të Greqisë, nuk ka të bëjë fare me bisedimet e

Rama uron Zaev: Një derë e re e së ardhmes u hap

Ndryshimet kushtetuese në Maqedoni, Meta: Hap i duhur drejt BE

Kuvendi i Maqedonisë miratoi dje me 90 vota pro nismën për ndryshimet kushtetuese duke i hapur rrugë ndryshimit të emrit nga Republika e Maqedonisë në Republika e Maqedonisë së Veriut. Me votimin e nismës qeveria fitoi 15 ditë për të përgatitur amendamentet dhe për t'i kthyer sërish në procedurë parlamentare. Tirana zyrtare e përshëndeti nismën kushtetuese në Maqedoni duke e konsideruar si një hap të rëndësishëm shprese për rrugën e Maqedonisë drejt NATO-s e Bashkimit Europian. Kreu i shtetit shqiptar Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, kreu i PD-së Lulzim Basha dhe ministri i Jashtëm Ditmir Bushati përgëzuan kryeministrin Zaev për përpjekjet në këtë drejtim. "Votimi në Kuvendin e Maqedonisë për nismën për ndryshimet kushtetuese është një hap i rëndësishëm, shprese e besimi se procesi i anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe BE është në rrugën e duhur. E përgëzoj qeverinë e kryeministrin Zaev për përpjekjet e vendosura në këtë drejtim dhe të gjithë ligjvënësit e Kuvendit të Maqedonisë për mbështetjen e një procesi që jo vetëm çliron Maqedoninë nga një



ngërç integrimi disa vjeçar, por ndikon edhe në sigurinë, stabilitetin e mirëqenien e rajonit tonë", shkruan presidenti Ilir Meta. Edhe kryeministri Rama uroi kryeministrin e Maqedonisë Zoran Zaev për këtë 'moment historik' siç e quajti ai. Miratimi i kësaj nisme sipas Ramës është një derë e re e të ardhmes për dy popujt në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

lidhje me çështjen kombëtare e as me vendosmërinë e qeverisë "Rama" që përfshiu në bisedime me fqinj jugor të gjitha çështjet që i kishte mbuluar pluhuri i harresës

#nacionalizëmper teps", shkruan ai. Në një deklaratë për mediat, në të cilën foli për financimet e shtetit grek në mediat shqiptare, Idrizi ironizoi ministrin Bushati ndërsa tha se: E ftojme min-

BASHA TAKON ÇAVUSOGLU: HISTORI BASHKËPUNIMI MES DY VENDEVE

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha takoi dje Ministrin e Jashtëm turk Mevlüt Çavusoglu. Përmes një postimi të shkurtër në "Facebook" lideri i opozitës theksoi se bashkëpunimi mes dy vendeve do të njohë fuqizim në sfidat e përbashkëta të së ardhmes. "Takim i përzemërt me ministrin e Jashtëm turk Mevlüt Çavusoglu. Një histori e konsoliduar mbështetje dhe bashkëpunimi mes dy popujve dhe vendeve tona, e cila do të njohë fuqizim në sfidat e përbashkëta të së ardhmes", shkruan Basha, ndërsa postoi edhe disa foto nga takimi në fjalë.



istrin Bushati të vazhdojë të përshëndesë bashkëpunimin e turpshëm me homologun Kotzias të investuar direkt me Fonde Sekrete në dem të interesave Kombëtare të Shqipërisë.



Preken ishujt e Sarandës nga 12 miljet greke? MPJ: E vërteta e marrëveshjes

Kotzias: Greqia gati të zgjerojë ujërat territoriale me 12 milje

"Zgjerimi në krahun perëndimor, nga 6 në 12 milje detare"

Valentina Madani

Ish-ministri i Jashtëm, Nikos Kotzias, dorëzoi dje zyrtarisht detyrën e tij, por gjatë ceremonisë së dorëzimit të portofolit të kryeministri Aleksis Tsipras, ish- kryediplomati grek deklaroi se Greqia është gati të zgjerojë ujërat territoriale me 12 milje detare. "Është e rëndësishme një politikë zgjerimi e sovranitetit të vendit, që prej kohës kur Greqia përfshiu ishujt Dodecanese, (më i madhi i të cilit është ai i Rodosit). Dekretet presidenciale janë gati", deklaroi ish-ministri i Jashtëm grek. Njoftimi, zgjeron zonën detare nga ishujt Diapontia, një grup ishujsh të vegjël në detin Jon - ku bën pjesë edhe Otonoi, - deri në Antikythera, një ishull që shtrihet mes Peloponezit dhe Kretës. Nikos Kotzias dha dorëheqjen nga posti i ministrit të Jashtëm pas një debati për "fondet sekrete" me ministrin e Mbrojtjes, Nikos Kamenos, ndërkohë që debati ka përfshirë edhe Shqipërinë. Kotzias pati mosmarrëveshje me kreun e partnerit në koalicionin e qeverisë së majtë, njëkohësisht ministër i Mbrojtjes, Panos Kamenos. Kamenos akuzoi Kotzias se ka shpërdoruar fondet sekrete të ministrisë së Jashtëm greke, para që, sipas medieve, greke, janë përdorur për të financuar edhe portale e gazetarë në Shqipëri. Ndërkohë që deklarata e djeshme e Kotzias, për kufirin detar, vjen pas një serie të gjatë negociatash me Shqipërinë, ku çështja e marrëveshjes së kufirit detar me Greqinë, ende nuk është arritur. Bisedimet mes Shqipërisë dhe Greqisë për kufirin detar dhe çështjet e tjera të vjetra që shqetësojnë dy vendet që drejtohen nga dy ministrit e Jashtëm Ditmir Bushati dhe Nikoz Kotzias, portashmë frenat e bisedimeve pritet që t'i marrë në dorë vetë shefi i ekzekutivit grek. Dy palët janë ende në diskutime, ndërsa Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta deklaroi të hënën në mbledhje në emisionin "5 Pyetjet nga Babaramo" se pakti me Greqinë nuk duhet



Ish-ministri i Jashtëm, Nikos Kotzias

NIKOS KOTZIAS

"Është e rëndësishme një politikë zgjerimi e sovranitetit të vendit, që prej kohës kur Greqia përfshiu ishujt Dodecanese, (më i madhi i të cilit është ai i Rodosit). Dekretet presidenciale janë gati", deklaroi ish-ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias dha dorëheqjen nga posti i ministrit të Jashtëm pas një debati për "fondet sekrete" me ministrin e Mbrojtjes, Nikos Kamenos.

DITMIR BUSHATI

"Çështja e zgjerimit të gjerësisë së detit territorial të Greqisë është një çështje e së drejtës ndërkombëtare, e cila ia njih këtë mundësi të gjithë shteteve, ashtu siç edhe Shqipëria e ka bërë një gjë të tillë prej vitesh. Por distanca e 12 miljeve nuk zbatohet në gjirin e Sarandës apo në zonat e tjera të detit territorial mes dy vendeve, pasi distanca në këto zona është nën 12 milje", -sqaroi MPJ.

Greqia miliona për portalet dhe gazetarët shqiptarë

Fondet e "zeza" greke për mediat, Tsipras e pranon: E bëjmë prej vitesh

Kryeministri i Greqisë, Aleksis Tsipras, pranoi dje se Greqia financon prej vitesh përmes "fondit sekret" media dhe gazetarë të huaj për t'i shërbyer interesave politike të Athinës. Pas skandalit që ka përfshirë Greqinë ditët e fundit për financime të portaleve dhe gazetarëve në Shqipëri dhe Magedoni, kreu i qeverisë greke dha shpjegimet e tij. Vetëm për muajin tetor rezultojn se Greqia ka paguar për mediat në Shqipëri shumën e 1 milion euro, ndër- sa e gjithë kjo veprimtari në disa vite ka kushtuar 45 milionë euro. Para këto të financuara në media, gazetarë dhe shoqata jofitimprurëse.

Tsipras pranoi ekzistencën e fondeve sekrete në Ministrinë e Jashtëm, duke deklaruar se kjo politikë ekziston prej vitesh dhe të gjithë e dinë këtë. "E kam diskutuar këtë debat që kur ishim në opozitë, në vitin 2011, kemi diskutuar për procedurën sa i përket transparencës së përdorimit të fondeve. Kemi krijuar një procedurë transparente për fondet sekrete. Nuk ka keqpërdorim të këtyre fondeve pa një firmë nga urdhëruesi, jo siç nododhte më përpara që i shpërdanin majtas e djathtas nëpër qese të zeza", deklaroi z. Tsipras.



DEKLARATA

"Kemi krijuar një procedurë transparente për fondet sekrete. Nuk ka keqpërdorim të këtyre fondeve pa një firmë nga urdhëruesi, jo siç nododhte më përpara që i shpërdanin majtas e djathtas nëpër qese të zeza", deklaroi z. Tsipras.

"E kemi krijuar një procedurë transparente për fondet sekrete. Nuk ka keqpërdorim të këtyre fondeve pa një firmë nga urdhëruesi, jo siç nododhte më përpara që i shpërdanin majtas e djathtas nëpër qese të zeza. Çdo vend që respekton veten e tij e ka për detyrë të përdorë një politikë të jashtëm ku të mbështetet, prandaj fondet sekrete janë një domosdoshmëri veçse ndokush ka kundërshtime. Debati që po behet kohet e fundit po behet në mënyrë të turpshme nga një pjesë e shtypit opozitar synon pikërisht të godasë këtë procedurë transparente", -tha Aleksis Tsipras, kryeministri i Greqisë.

REAGIMI

Ministria jonë e Jashtëm ndonëse në rrugë jo zyrtare

sqaroi dje se ishujt shqiptarë nuk preken nga synimi i Greqisë për zgjerimin e saj territorial. Ministria e Jashtëm e Shqipërisë reagoi dje pas deklaratave të ish-

ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias dhe synimit të Greqisë për të zgjeruar me 12 milje hapësirën territoriale detare, që, sipas saj, nga ky veprim nuk preken ishujt shqiptarë në gjirin e Sarandës. Ministria e Jashtëm sqaroi se: "Çështja e zgjerimit të gjerësisë së detit territorial të Greqisë është një çështje e së drejtës ndërkombëtare e cila ia njih këtë mundësi të gjithë shteteve, ashtu siç edhe Shqipëria e ka bërë një gjë të tillë prej vitesh, por distanca e 12 miljeve nuk zbatohet në gjirin e Sarandës apo në zonat e tjera të detit territorial mes dy vendeve, pasi distanca në këto zona është nën 12 milje". Burimet nga Ministria e Jashtëm thanë për ne Panorama se: "Parimi i 12 miljeve mund të aplikohet vetëm në rastet kur deti territorial i një shteti nuk mbivendoset me detin territorial të shtetit fqinj ku distanca është më e vogël se 24 milje". Burime nga Ministria e Jashtëm theksuan më tej se: "Neni 3 i konventës për të drejtën e detit u njeh shteteve të drejtën e shpalljes së detit territorial deri në 12 milje detare, por kjo e drejtë duhet të shprehjet me ligje të brendshme dhe këto ligje duhet të depozitohen në OKB. Nga ana e saj, Greqia ka ligjin e saj të brendshëm nr. 230 të vitit 1936, ka shpallur gjerësinë e detit të saj territorial deri në 6 milje detare. Pas bërjes palë e konventës në vitin 1956, Greqia ka shprehur synimin për të zgjeruar në të ardhmen detin territorial nga 6-12 milje detare".

Nënshkëtitësia greke, ulet tarifa. Kush nuk kalon testin me shkrim

Sekretari i shtetit për nënshkëtitësinë në Ministrinë e Brendshme greke, Lampros Baltiotis, ka bërë të ditur se së shpejti do të ulet tarifa (paravolo) që paguhet për aplikimin e marrjes së nënshkëtitësisë greke. "Paravolo prej 700 eurosh në raport me të ardhurat për frymë në Greqi, është ndër 3-4 më të shtrenjtat në BE. Do ta ulim, do ta bëjmë 550 euro. Madje shpresojmë që këto para të shfrytëzohen tash e tutje për të përmirësuar gjithë procedurën, dome-thënë, ato para "tu kthehen" me shërbim cilësor atyre që i kanë paguar", deklaroi z. Lampros Baltiotis për TV Tribuna. Ai bëri të qartë se: "Do të kemi muajin e ardhshëm votim në një amendamenti që e kishim paralajmëruar që nga marsi 2018, por e vonuam. Katë bëjmë me ata që janë mbi 65 vjeç. Për ata që janë me moshë mbi 65 vjeç, do të ketë një rregullim të veçantë që parashikon se testi do të jetë mjaft më i lehtë dhe kërkesat për komunikimin verbal në greqisht do të jenë të njëjta - dhe në këtë pikë shqiptarët në Greqi nuk e kanë problem.

Vlerësimi, Frattini-Velaj: Eja drejto bashkinë e Romës

Gjatë takimit që pati me kryebashkiakun Erion Velaj, ish-ministri italian i Punëve të Jashtëm, Franco Frattini, evidentoi ndryshimet që ka pësuar Tirana në një kohë të shkurtër dhe i kërkoi që nëse do të ishte e mundur të bëhej edhe kryebashkiak i Romës, duke nënvizuar se kryeqyteti Italian ka probleme të mëdha me infrastrukturën. "Kam qenë këtu për herë të fundit në 2013, dhe u riktheva sot, dhe gjeta një qytet më të bukur, më të pastër, dhe mbi të gjitha rrugë të mrekullueshme që duhet t'i kemi edhe në Romë, ku fatkeqësisht ka shumë gropa. Kështu që, kryebashkiak, eja edhe në Romë dhe të na tregosh si bëhen mirë këto punë", u shpreh Frattini. Franco Frattini, ish-ministri italian i Punëve të Jashtëm të Italisë, e kishte vizituar Tiranën për herë të fundit në vitin 2013, kur edhe mori titullin "Qytetar Nderi", në kohën kur qyteti drejtohej nga Lulzim Basha dhe qeveria nga Sali Berisha.

VETINGU NE POLICI AKUZAT

Strazimiri: Vetingu i policisë është ndërprerë. U zbuluan shumë ish-sigurimsa në drejtim

"Xhafaj po fsheh skandalin", PD: 534 drejtues policie, ish-sigurimsa

"Autoriteti të publikojë listën me sigurimsa"

Valentina Madani

PD përmes nënkryetarit të grupit parlamentar Gent Strazimiri denoncoi dje atë që e quan si skandal, që konfirmon drejtimin e Policisë së Shtetit nga drejtues të lartë që kanë pasur lidhje me Sigurimin e Shtetit gjatë kohës së diktaturës. Sipas Strazimirit, procesi i vetingut në polici duhej të kishte nisur gjatë shtatorit, por ai, në fakt, është ndërprerë, pas verifikimit të 534 drejtues të lartë policorë që kanë qenë funksionarë të diktaturës. "Ky institucion ka detyrimin ligjor të publikojë informacionin mbi praktikën në fjalë dhe jo ta fshehtë atë! PD i kërkon Autoritetit të Dosjeve të mos bëhet vegël e Sigurimit të Shtetit, por të publikojë listën me sigurimsat në drejtimin e Policisë së Shtetit", deklaroi deputeti i PD-së. Sipas Strazimirit, skandali po mbahet i fshehtë nga Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, një ish-hetues i regjimit të diktaturës, por gjurmët e skandalit janë lënë në zyrat e Autoritetit të Dosjeve. "Partia Demokratike është vënë në dijeni se verifikimi është ndërprerë, pas një takimi mes Kryetares së Autoritetit të Dosjeve, Gentjana Sula dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Ardi Veliu, i cili është informuar zyrtarisht për 534 drejtuesit e rangut të lartë të Policisë së Shtetit, pjesë e Sigurimit të Shtetit" tha ai. Strazimiri përmendi se komisioni hetimor për largimet nga detyra në polici, provoi zyrtarisht se qindra sigurimsa të nxjerrë në lirim ishin rikthyer në punë në mënyrë të jashtëligjshme, me vendim politik, pas një kontributi publik në radhët e partisë së Enver Hoxhës që sot drejtohet nga Edvin Rama. "Komisioni hetimor provoi se kupola në fjalë ka kontribuar në zgjedhjet e 2013 si komisionerë, vëzhgues apo edhe financues i PS madje në shumica dhjetëra mijëra euro. Statistikat konfirmojnë se rikthimi më

detyrë i funksionarëve të Sigurimit të Shtetit dhe bashkëpunëtorëve të tij në nivele drejtuese është më i lartë se në vitin 1997. 534 sig-

urimsat që drejtojnë sot Policinë e Shtetit janë arsyeja pse procesi i vetingut në polici është ndërprerë dhe zurma e madhe e Fatmir Xhafa-

jt dhe e Edi Ramës është zëvendësuar me heshtje. Përmes tyre partia e Enver Hoxhës që, sot drejtohet nga Edvin Rama, arriti të kanabizojë vendin, ta bëjë Shqipërinë, si kurrë më parë, vend miqësor ndaj organizatave kriminale të trafikimit me shumicë të heroinës dhe kokainës", theksoi z.Strazimiri. Ai shoi se "falë tyre dhe standardit mafioz të "omerta-s", të kultivuar dhe trashëguar nga Sigurimi i Shtetit, Policia e Shtetit u shndërrua këto 5 vjet në një organizatë po aq të dëmshme për rendin dhe sigurinë publike. Pavarësisht se i krijuar nga partia e Sigurimit të Shtetit, "Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit" ka detyrimin ligjor të publikojë informacionin mbi praktikën në fjalë dhe jo ta fshehtë atë!"



Nënkryetari i grupit parlamentar Gent Strazimiri

Reagimi pas akuzave për "policët ish-sigurimsa"

Autoriteti i Dosjeve: Vlerësimi, në bazë të cilësive profesionale

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit reagoi dje pas deklaratës së deputetit demokrat, Gent Strazimiri, sipas të cilit procesi i vetingut është ndërprerë, sepse 534 drejtues të lartë të Policisë së Shtetit janë verifikuar se i kanë shërbyer sigurimit të shtetit. Autoriteti sqaron se institucionet Kushtetuese, Autoritete Publike, përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kanë paraqitur në vijimësi pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit kërkesa ku është kërkuar vlerësimi i cilësive etiko-morale dhe profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel drejtues në raste të emërimit apo ngritjes së tyre në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit



29, pika 1, germa "e" të ligjit 45/2015, "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit...". Autoriteti shprehet se rezultatet e verifikimit për çdo rast janë komunikuar institucioneve, të cilat kanë paraqitur kërkesën dhe në asnjë rast nuk ka pasur nga ana jonë ndërprerje të procesit të filluar. "Deri më sot, pranë autoritetit nuk është paraqitur

asnjë kërkesë e shoqëruar me formularët përkatës të plotësuar nga vetë subjektet dhe Organet e Vlerësimit Kalimtar sipas ligjit nr.12/2018 (Vetingu në polici)", - thuhet në reagimin e Autoritetit të Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Autoriteti shprehet se me disponimin e një kërkesë të tillë ligjore, menjëherë do të kryejë procesin e verifikimit të figurës së çdo punonjësi që i nënshtrohet kontrollit, konkretisht nëse ka qenë person në ndjekje për spionazh apo terrorizim, anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit për të drejtën e informimit me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.



Gjatë një seance parlamentare

KËRKESA

Partia Demokratike i kërkon Gentjana Sulës të mos bëhet vegël e Sigurimit të Shtetit, por të bëjë publike pa vonesë listën me 534 drejtuesit e lartë të Policisë, të lidhur me Sigurimin e Shtetit. Sipas Strazimirit, skandali po mbahet i fshehtë nga Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, një ish-hetues i regjimit të diktaturës, por gjurmët e skandalit janë lënë në zyrat e Autoritetit të Dosjeve.



Më e shtrenjta në rajon, Tabaku: Shqiptarët paguajnë naftën, "sa frëngu pulën"

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, shkruan se shqiptarët e paguajnë karburantin më shtrenjtë se njerëzit e tjerë të rajonit. Përveç kësaj ajo shton se nafta që blihet është e cilësive së dobët. Për këtë deputetja ka bërë fajtor qeverinë duke shkruar në "Facebook": "Shkurt dhe shqip, qytetarët sot paguajnë naftën më shtrenjtë se në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi apo dhe Zvicër. Shtrenjtimi i çmimit të naftës nuk është vetëm pasojë e rritjes së çmimit të naftës bruto në bursë, por është një investim personal i qeverisë, e cila duke vendosur një shumëllojshmëri taksash dhe duke rritur tarifën e tjera kanë ndikuar në rritjen e çmimit". "Tanimë është e qartë se ajo çfarë parashikojmë për taksat e vendosura nga një mazhorancë e papërgjegjshme po kthehet në një peshë të rëndë për qytetarët. Pasi sot ne paguajmë 110 lekë taksë në çmimin prej 184 lekësh që blejmë një litër karburant. Një peshë që ka ndikuar në rritjen e çmimeve të produkteve dhe uljen e konsumit për shkak të shtrenjtimit të ofertës dhe pamundësisë së të ardhurave. Kjo do të shoqërohet me mbyllje qepenash pasi biznesi do të kthehet në pamundësi", tha zj.Tabaku. Madje Tabaku shprehet se qeveria nisi të ndërmerre një tjetër koncesion për t'i dhënë kontrollin e naftës një kompanie të paracaktuar. "E vetmja rrugë për uljen e çmimit të naftës është një politikë e re fiskale që mbron dhe stimulon konsumin, që mbron qytetarët nga abuzimet dhe krijimi i monopoleve private me bekimin e qeveritarëve që i zotërojnë ato. Ka ardhur koha që shqiptarët të paguajnë më pak për çmimin e një litre naftë dhe kjo mund të arrihet vetëm në sajë të politikave fiskale të qeverisë demokratike. Taksë e sheshtë dhe thjeshtim fiskal në shërbim të konsumit dhe qytetarëve", deklaroi deputetja e PD-së.



Kryeministri, ironi me akuzat ndaj të vëllait: Çudi që nuk u përmend Taulanti

Rama: Do të bllokojmë edhe bastet në faqet e huaja

"Ministrat nuk ua hapin telefonat deputetëve"

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në anëtarësimet e reja të Partisë Socialiste në Kamzë, deklaroi dje se do të bllokohe të gjitha bastet "online", përfshi edhe kompanitë e huaja. Kryeministri ripërsëriti vendosmërinë për të mbyllur njëherë e mirë bastet sportive dhe kazino-të. Ai akuzoi opozitën se ka dalë në krah të kësaj industrie, sipas tij të kriminalizuar, dhe këtë tha Rama po e bën duke hedhur baltë mbi vëllain e tij. Por, shtoi kryeministri, e vetmja gjë e mirë është se në këto akuzë nuk del emri i deputetit Taulant Balla. "Ne sot jemi në prag të marrjes së një vendimi që disa i ka mërzhitur, por shumicën besoj se e ka kënaqur dhe sidomos gratë, vajzat, nënat nëpër shtëpia, mbylljen e basteve dhe të lojërave të fatit. Sot më thanë që paskan organizuar dhe protestë këta lojtarët e fatit. Nuk i organizojnë këta, i organizojnë tjetërkush, i organizojnë ata që e financojnë këtë industri", deklaroi z.Rama.



Kryeministri Edi Rama dje në Kamzë

shikohet mundësia edhe për bllokimin e basteve online që janë jashtë. "Ne tani po shohim me ekspertë, kemi ngritur një grup ekspertësh për të bllokuar edhe bastet online që janë jashtë, sepse sot luhet nëpër telefona dhe kompjuter jashtë shtetit. Para nga këtu shkojnë jashtë shtetit përmes kartave të kreditit dhe janë dhe ato miliona e miliona që i merr lumi. Por do të shikojmë si do ta realizojmë këtë gjë", theksoi z.Rama. Kryeministri përmendi se qytetarët kanë akses në çdo kohë për të përcur ankesën në platforma e lanuar online dhe brenda 10 ditësh, qytetarët marrin përgjigjen e problemit të ngritur prej tyre. Shefi i qeverisë tha se ka ikur koha e takimeve dhe miqësive për të marrë një shërbim, pasi shqetësimet tashmë kanë një platformë ku adresohen dhe kjo bëhet thjesht me një telefon. Ministrat shpesh nuk hapin telefonin deputetëve. Ministri vetë është i detyruar ta shqyrtojë ankesën, sepse mban përgjegjësi", theksoi z.Rama.

KRIKITA

Shefi i qeverisë tha se ka ikur koha e takimeve dhe miqësive për të marrë një shërbim, pasi shqetësimet tashmë kanë një platformë ku adresohen dhe kjo bëhet thjesht me një telefon. Ministrat shpesh nuk hapin telefonin deputetëve. Ministri vetë është i detyruar ta shqyrtojë ankesën, sepse mban përgjegjësi', - theksoi z.Rama.



"Spitali i Fierit", Shehu sulmon Ramën: Syzet 3D ia nxorën dyert e vogla

Kryeministri Rama gjatë vizitës në spitalin e Fierit, e pranoi se në sistemin shëndetësor ka ende punë për të bërë, pasi disa prej mjekëve dhe infermierëve vazhdojnë të nullojnë bluzat e bardha. "Patjetër që ka midis tyre njerëz që e nullojnë, si të thuash, përparësen e bardhë, por shumica nuk janë absolutisht ashtu. Edhe me projektbuxhetin do të bëjmë një shtesë tjetër të pagës, të konsiderueshme, për infermierët dhe për mjekët", tha z.Rama. Por deputeti i PD-së, Titan Shehu reagoi pas vizitës se kreut të qeverisë në Fier. Sipas tij, Rama nuk tha asgjë për PPP-të, ndërsa shtoi se asnjë fjalë nuk u tha për politikën shëndetësore dhe sipas tij, mjekëve u është kërkuar të kryejnë një numër procedurash kirurgjikale me të njëjtat instrumente pa asnjë sterilizim. "Kryeministri në spitalin e Fierit, nuk tha asgjë për faktin që PPP e sterilizimit dhe e materialeve konsumit po bën kolaps. Ai me syzet e tij 3 D, këtë herë konstatoi vetëm se dyert janë të vogla, i vetmi konkluzion e direktive kryeministrialet kjo. Asnjë fjalë nuk tha për politikën shëndetësore financuese e zhvilluese të sistemit, të domosdoshme këto për shëndetësinë tonë në varfëri afrikane, me mjekje si "specie në zhdukje" dhe e fundit në Europë për kujdesin ndaj të pacientit. Asnjë fjalë për dështimin e PPP të sterilizimit të materialeve të konsumit. Kirurgëve e kryeinfermiereve të sallave u është kërkuar që për një numër procedurash kirurgjikale të përdorin përsëri instrumentet e vjetër dhe jo ato nga koncesionari i sterilizimit, se po "tejkalohehet kostoja", megjithëse atij i paguhen shuma gjigande, rreth 13 M \$ ne vit, duke konfirmuar kështu akuzat tona për abuzim dhe jo rentabilitet në këtë PPP?", shprehet deputeti i PD-së.

AKUZAT

Kryeministri akuzoi se: "Për fat të keq në këtë rast, këtë gjë e mbështet dhe opozita qartësisht duke hedhur baltë që kjo bëhet sepse vëllai etj., etj. do të mbajë një... Të paktën në këtë rast nuk kanë përmendur Taulantin, kjo është gjë e madhe. Çuditërisht në këtë rast Taulanti nuk del gjëkund. Por e vërteta është se do të mbylljen të gjitha". Kryeministri vuri në dukje se me mbylljen e lojërave të fatit i jepet fund dhe një plage të rëndësishme sociale, teksa nuk kurseu dhe batutat për tifozët e Interit. "Janë mërzhitur me shumë se të gjithë tifozët e Interit se mendojnë se tani u ka ardhur dita të fitojnë, por, në fakt, ata do të jenë më të kënaqurit, sepse ata nuk kanë për të fituar dot dhe do ta kuptojnë që më mirë që u mbyllën për të gjithë sesa të rrinin duke humbur, sepse ngelën duke vënë gabim skedimin. Kanë 10 vjet që u torturuan. Përtej shakasë, është një zhvillim shumë i fortë për të mbyllur një industri të kriminalizuar për fat të keq, një industri që financohet në masën e vet më të madhe nga krimi i organizuar dhe që është një industri pastrimi parash, një industri që praktikisht krijon dëshpërim", shpreh kreu i qeverisë. Sipas

tij: "Në studimet e bëra rezultojnë që një nga katër lojtarë fati kanë menduar të paktën një herë të vrasin veten. 70 e ca për qind e tyre jetojnë në stres dhe ajo çfarë është më e tmerrshme në Shqipëri është se 68 për qind e lojtarëve e fillojnë këtë rrugë 10-15 vjeç, kjo është e pakoncept-

ueshme. Përfytyro të gjithë prindërit, nënat sidomos, që bëjnë gjithçka për të rritur fëmijët dhe që fëmijët tu kthehen në të sëmure nga ideja dhe vesi i lojës së fatit. Do t'i mbyllim ndryshe nga çfarë thuhet dhe përfillet".

BLLOKIMI

Shefi i qeverisë tha se po

Akademiku Fuga pro nismës së Ramës për shpifjen: Shqipërisë i duhet ligji

Akademiku Artan Fuga, i ftuar dje në emisionin "Kjo javë" në "Neës24" u shpreh pro nismës së kryeministri Edi Rama për shpifjen. Sipas tij Shqipërisë, i duhet një kuađer ligjor për shpifjen në media, por jo sipas rrjedhës që ka marrë pas deklaratave të Ramës. "Unë mendoj se Shqipërisë i duhet një ligj. Nuk jam dakord me ata që thonë; se ligjet janë. Nëse do bëhet një ligj për fyerjet, për cenimin e privatësisë në media kërkon që të vendoset një kuađer normativ në specifikën e mediave, siç është edhe ajo online. Për mua i duhet, por jo në këtë mënyrë se si ka marrë rrjedha. Nuk mund të mendohet se në vende si Danimarka, apo Norvegjia të futen në burg gazetarët. Nuk duhet gjykar teksti, por realiteti. Duhet pasur parasysh se këtu bën



MBËSHJETJA

"Shpesh herë shpifja dhe gjoba për shpifjen janë në marrëdhënie për tregun. Është e detyruar që të mbrohet qytetari nga shpifjet, pasi është dëm i pallogaritshëm. Është nuk ka një normë kundër shpifjes dhe gënjeshtëris, atëherë cili është problemi?", tha z.Fuga.

kujdes edhe gazetari, edhe media. Shpesh herë shpifja dhe gjoba për shpifjen janë në marrëdhënie për tregun. Është e detyruar që të mbrohet qytetari nga shpifjet, pasi është dëm i pallogaritshëm. Nëse nuk ka një normë kundër shpifjes dhe

gënjeshtëris, atëherë cili është problemi? Të gjitha konsiderohen si opinione. Ligji nuk bëhet për një qëllim, që t'i shërbejë një grupi; pushtetarëve apo opozitës. Ligji mbrohet qytetarin", u shpreh akademiku Artan Fuga.

Sali Lushaj: Djali s'është pjesë e grupit kriminal

"Stresi ka qenë në Shkodër për koncert, mund të ketë komunikuar me Bajrët për këtë arsye

TIRANË - "Djali ka shkuar 3-4 herë në Shkodër për koncert dhe ka ndërmjetësuar në disa lokale. Mund të jetë i vërtetë komunikimi me Bajrët, por është bërë për këtë qëllim. Pastaj të kërkosh ndihmë të dalësh jashtë nuk është vepër penale" Kështu është shprehur dje në studion e emisionit "Kjo Javë" në 'News 24', Sali Lushaj, babai i reperit të njohur Stresi. Gjatë emisionit, ai foli edhe për përgjimet e prokurorisë, në të cilat i biri rezultoi të flasë më anëtarë të bandës së Bajrajve. Lushaj pohoi Stresi ka kënduar në lokalit të tyre, dhe komunikimi me ta ka

POLITIKA

Arrestimi pak ditë më parë i Arkimed Lushajt ku shihej gati nudo në një dhomë hoteli në Linzë, i mbuluar vetëm me çarçaf bëri xhiron e mediave. Nëna e këngëtarit të njohur të repit, Stresi, pohoi se djali i saj ka gati padinë civile që do ta deponojë në gjykatë, për prishje të etikës dhe të privatësisë së

qenë për këtë arsye. Ndërsa i pyetur në lidhje për akuzën për grup kriminal dhe shoqërinë e të birit, Sali Lushaj pohoi: E njoh shumë mirë

shoqërinë e tij. Garantoj me jetë. Stresit vetëm grup kriminal s'mund t'i thuash. S'di ku i gjejnë këta njerëz, Si do bëjnë t'i gjejnë. Kam për

detyrë mos më shoh njeri me sy, nëse im bir është marrë me trafik. Arrestimi pak ditë më parë i Arkimed Lushajt ku shihej gati nudo në një dhomë hoteli në Linzë, i mbuluar vetëm me çarçaf bëri xhiron e mediave. Nëna e këngëtarit të njohur të repit Stresit, pohoi se djali i saj ka gati padinë civile që do ta deponojë në gjykatë, për prishje të etikës dhe të privatësisë. "Dje mori masën 'arrest me burg'. Ai ndodhet



Sali Lushaj

në Fushë-Krujë. Do ta vizitojmë në ditët në vijim. Kam një padi civile. Atë do ta paraqesë Stresi për prishjen e etikës dhe privatësisë. Ai ka ankumuar vendimin e gjykatës dhe anashkalimin

e tij", tha Shpresa Lushaj, 31-vjeçari u prangos në një hotel në periferi të Tiranës, afër Dajtit, pasi akuzohet për armëmbajtje pa leje dhe pjesëmarrje në një bande kriminale.

Laboratori i heroinës në Has, linja e trafikut: Afganistan-Turqi-Kosovë-Shqipëri

HAS

Dy ditë pas zbulimit të laboratorit të heroinës, policia është larguar nga fshati Brenog i Hasit. Në derë të laboratorit ku u gjet një sasi prej 250 kg heroinë dhe përzierës qëndrojnë vetëm 2 punonjës policie që nuk lejohen askënd që të depërtojë në brendësi të tij. E ndërsa banorët e fshatit i janë rikthyer rutinës së përditshme, të afërmit e familjes Shutit thanë se ishin terrorizuar nga policia. "Erdhën dhe arrestuan të gjithë familjen, policia arrestoi Xhevitin së bashku me bashkëshorten Anilën duke lënë vetëm dy fëmijët e mitur. Policia mori edhe djalin 15-vjeçar. Që prej arrestimit nuk kemi pasur asnjë kontakt me ta, fëmijët janë terrorizuar. Nëna e Xhevitit është e paralizuar dhe ka nevojë për shërbim", u shpreh motra e Xhevit Shutit. I kontaktuar nga 'News 24', daja i 48-vjeçarit që u vu në pranga tha se nuk ka dajeni se me çfarë merreshin nipërit e tij dhe se në këtë fshat kishte ardhur për të takuar motrën. Gjatë operacionit antidrogë u arrestuan pesë persona dhe konkretisht: Mustafë Shutit, Xhevit Shutit, Anila Shutit, Xhebi Barushi si dhe efektivit e zjarrfikësës, Flamur Çela. Ndërkohë, mësohet se policia është në kërkim edhe të 5 personave të tjerë, pasi dyshohet për një rrjet trafikur ndërkombëtar. Laboratori ishte vendosur në periferi të fshatit Brenog jo shumë larg Kukësit. Pas lokalizimit të tij, policia e mbajti nën vëzhgim zonën, ndërsa para ndërhyrjes zona u monitorua me dron. Policia shfrytëzoi mbërrijtjen në shtëpinë e Xhavit Shutit të një traktori me lëndë drusore. Më pas u bë

"Policia na terrorizoi, në shtëpi mbetën e moshuara e paralizuar dhe 2 fëmijë të mitur"

Të afërmit e Xhevit Shutit: Arrestuan gjithë familjen



Laboratori i drogës në Has



PERSONAT E ARRESTUAR

1. VEHBI BARUSHI
2. XHEVIT SHUTI
3. ANILA SHUTI
4. MUSTAFË SHUTI
5. FLAMUR ÇELA

sekustrimi i lëndës narkotike dhe arrestimi i 5 personave në fjalë, tre prej të cilëve nga familja Shutit. Burime të besueshme bëjnë me dije se përzierësit e heroinës dhe një sasi opiumi kanë hyrë në territorin sh-

qiptar nga Kosova. Ato kanë origjinë Afganistanin dhe në rrugë tokësore nëpërmjet Turqisë kanë mbërritur deri në Kosovë. Më pas me ndihmën e disa shtetasve nga Gjakova (të identifikuar nga policia) kanë mbërritur në fshatin Brenog të Hasit dhe konkretisht në banesën e familjes Shutit. Ndërkaq, dyshimet e policisë janë se me pas ajo transportohej për në Durrës me destinacion final vendet e Evropës. Personi më i rëndësishëm në këtë skemë trafikur është Xhevit Shutit. Ai rezultoi me precedentë

ZBULIMI I LABORATORIT

Laboratori ishte vendosur në periferi të fshatit Brenog jo shumë larg Kukësit. Pas lokalizimit të tij, policia e mbajti nën vëzhgim zonën, ndërsa para ndërhyrjes zona u monitorua me dron. Policia shfrytëzoi mbërrijtjen në shtëpinë e Xhavit Shutit të një traktori me lëndë drusore. Më pas u bë sekustrimi i lëndës narkotike dhe arrestimi i 5 personave në fjalë, tre prej të cilëve nga familja Shutit.

LINJA TRAFIKUT

Burime të besueshme bëjnë me dije se përzierësit e heroinës dhe një sasi opiumi kanë hyrë në territorin shqiptar nga Kosova. Ato kanë origjinë Afganistanin dhe në rrugë tokësore nëpërmjet Turqisë kanë mbërritur deri në Kosovë. Më pas me ndihmën e disa shtetasve nga Gjakova (të identifikuar nga policia) kanë mbërritur në fshatin Brenog të Hasit dhe konkretisht në banesën e familjes Shutit.

penalë, pasi vite më parë është dënuar në Turqi për narkotikë. Xhevit Shutit kryente me furgonë transport pasagjerësh në linjën Has-Durrës. Dyshohet se në këtë

linjë trafikur janë përfshirë edhe vëllezërit e tij, të cilët po ashtu merren me transport ndërkombëtar. Megjithatë roli i tyre nuk është përcaktuar ende nga policia.



I gjeten 30 doza kokainë në banesë, prangoset i riu

VLORË - Një 27-vjeçar nga Vlora ka përfunduar një pranga, pasi është kapur me kokainë në automjetin e tij. Bëhet fjalë për të riuin, Pavli Lulaj lindur në fshatin Gjorm dhe banues në qytetin bregdetar. Mësohet se ai u kap në flagrancë në lagjen "10 Korriku" në Vlorë, në banesën e tij. Sipas bluve, gjatë kontrollit të banesës është gjetur dhe sekustruar në cilësinë e provës materiale: 30 doza të dyshuara si kokainë; një autoveturë e markës "Fiat Punto" ngjyrë jeshile, me targë AA 845 AZ si dhe një celular. Materialet në ngarkim të 28-vjeçarit iu referuan për hetime të mëtejshme prokurorisë për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/694-2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PROMËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.900.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Deputeti Flamur Noka: Dënojmë çdo akt dhune, banditët e pushtetit po bëjnë terror

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Atentati, qëllohet me breshëri plumbash makina e aktivistit të PD-së, Pjerin Kaçi

Mjeti tip "Kyron" u godit me 15 plumba, biznesmeni: Nuk i njoh autorët, nuk kam konflikte me askënd

Tri ditë më parë, në orët e pasdites ka ndodhur një tjetër ngjarje kriminale në Shkodër. Makina e biznesmenit dhe aktivistit të njohur në radhët e PD-së Pjerin Kaçi është qëlluar me armë zjarri. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Sektor të njësisë Velipojë. Sapo ka zbritur nga makina dhe ka qenë duke shkuar në një lokal, persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar në makinën e anëtarit të PD-së. Mësohet se mjeti tip "Kyron" me targë AA 497 UK është qëlluar në pjesën e përparme, por edhe në pjesën e pasme të saj. Sipas burimeve makina e Kaçit është qëlluar me rreth 15 plumba nga autorët e krimit. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se në ato moment biznesmeni është futur brenda lokalit dhe ka qëndruar në katën e dytë për t'u shpëtuar plumbave dhe atentatit ndaj tij. Pasi kanë qëlluar mjetin e Pjerin Kaçit, agresorët janë larguar me shpejtësi në drejtim të paditur. Policia është njoftuar për këtë atentat dhe ka mbërritur në vendngjarje pasditen e 18 tetorit, ndërsa ka nisur hetimet. Deri më tani efektivet ende nuk kanë arritur që të identifikojnë autorët që qëlluan makinën e biznesmenit. Oficerët e policisë kanë marrë në pyetje Kaçin lidhur me këtë ngjarje, por shtetasi i sulmuar ka deklaruar se nuk e ka idenë përse i është bërë ky atentat dhe se kush mund të jenë autorët. "Nuk e di se kush mund të jenë autorët dhe përse ka ndodhur kjo ngjarje. Unë nuk kam ndonjë konflikt me persona të tjerë", është shprehur biznesmeni, ndërsa ka dyshime se mund të ketë ndodhur për shkak të bizneseve apo edhe si aktivist i njohur në radhët e PD-së.



Biznesmeni Pjerin Kaçi



Makina e qëlluar nga plumbat

BIZNESMENI

Oficerët e policisë kanë marrë në pyetje Kaçin lidhur me këtë ngjarje, por shtetasi i sulmuar ka deklaruar se nuk e ka idenë përse i është bërë ky atentat dhe se kush mund të jenë autorët. "Nuk e di se kush mund të jenë autorët dhe përse ka ndodhur kjo ngjarje. Unë nuk kam ndonjë konflikt me persona të tjerë", është shprehur biznesmeni, ndërsa ka dyshime se mund të ketë ndodhur për shkak të bizneseve apo edhe si aktivist i njohur në radhët e PD-së.

këtë akt kriminal. "Sigurisht që qëndrimi jonë ka qenë dhe është i pandryshueshëm. Bandat e pushtetit gjithkund jo sot, por vazhdimisht ushtrojnë presion dhe terror.

Dënojmë çdo akt dhune ngado dhe sido që të vijë", -u shpreh deputeti Noka nga Shkodra. I pyetur se në pak kohë në Shkodër ka dy makina të qëlluara me armë zjarri,

PRECEDENTI

Ngjarja e ndodhur të enjten në zonën e Velipojës nuk është bërë me dije nga policia e Shkodrës dhe as nga Policia e Shtetit edhe pse është një atentat kriminal ndaj një biznesmeni dhe aktivistit të PD-së në këtë zonë. Po ashtu pak ditë më parë një fuoristradë u qëllua në Shkodër dhe u braktis nga personi që ishte brenda saj. Edhe pse mjeti kishte të paktën 30 plumba dhe njolla gjaku, policia tentoi ta lërë në heshtje atë ngjarje.

fatim e keq, Shqipëria është në prag të destabilitetit dhe jo thjeshtë nga bandat, por me shumë nga bandat në pushtet se sa bandat e rrugës", -përfundoi deputeti Noka.

DEPUTETI NOKA

I ndodhur në Shkodër në procesin e zgjedhjeve për kryetarët e grupseksioneve në PD-në e Shkodrës si i deleguar nga qendra, deputeti Flamur Noka tha se dënon këtë akt kriminal. "Sigurisht që qëndrimi jonë ka qenë dhe është i pandryshueshëm. Bandat e pushtetit gjithkund jo sot, por vazhdimisht ushtrojnë presion dhe terror. Dënojmë çdo akt dhune ngado dhe sido që të vijë", -u shpreh deputeti Noka nga Shkodra.



Trafikonte mina me telekomandë, arrestohet i ri

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka goditur një tjetër rast të trafikimit të minave me telekomandë. Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e personave që tentojnë të trafikojnë armë zjarri e lëndë plasëse, është bërë e mundur arrestimi në flagrancë i 28-vjeçarit Petraq Kote, banues në Tiranë. Nga kontrolli i ushtruar, të riut Kote, në ambientet e një lokali në fshatin Mengel, Njësia Administrative Labinot-Fushë, iu gjetën 4 mina me shpërthim në distancë, të pajisura me aparat telefoni celular me bateri, fije përcjellëse dhe magnet, të cilat u sekuestruan në cilësimin e provës materiale. Policia bëri me dije se vijon operacionin për identifikimin e shtetasit /shtetasve, të cilëve Petraq Kote do t'ua shiste. Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan.

Familjarët: Jemi të shokuar, s'e dimë pse ndodhi

U gjet i djegur në makinë, policia: 39-vjeçari spërkati mjetin me benzinë dhe i vuri flakën

KORÇË - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në lagjen nr.1 pranë kampit të punëtorëve ku një person ka gjetur vdekjen pasi makinë e tij ka marrë flakë. Ditën e djeshme, policia ka zbuluar detaje të reja në lidhje me ngjarjen, duke bërë me dije se 39-vjeçari Gjergji Babo i ka vendosur flakën vetes brenda në makinë. "Nga veprimet e para hetimore, rezultoi se ky shtetas ka marrë një sasi lëndë djegëse (benzinë) në një bidon plastik, në një nga karburantet e qytetit dhe dyshohet se i ka vënë flakën vetes brenda mjetit, ku për pasojë janë djegur plotësisht mjeti si edhe ky i fundit"-raportoi policia. Në vendngjarje shkuan shërbimet e policisë dhe zjarrfikësja, ku është bërë e mundur shuarja e zjarrit.



Ndërkaq, dje kanë reaguuar familjarët e 39-vjeçarit. Ata u shprehën për "GSH" se janë të shokuar nga ngjarja.

"Gjergji nuk vuante nga depresioni. Nuk e dimë pse ndodhi. Ai nuk kishte probleme ekonomike", - thanë familjarët e viktimës. Ndërsa

bënë me dije se 39-vjeçari jetonte me gjyshen në shtëpi, ndërsa babai dhe e motra jetonin në Amerikë. E ëma i kishte vdekur disa vite më parë.

HETIMET

"Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore ka rezultuar se Gjergji Babo ka marrë një sasi lëndë djegëse (benzinë) në një bidon plastik, në një nga karburantet e qytetit dhe dyshohet se i ka vënë flakën vetes brenda mjetit, ku për pasojë janë djegur plotësisht mjeti si edhe ky i fundit"-raportoi policia. Në vendngjarje shkuan shërbimet e policisë dhe zjarrfikësja, ku është bërë e mundur shuarja e zjarrit

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga 'Agjencia'

ALUIZNI: 1500 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Lista me pronarët në qarkun e Tiranës

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 1500 personat kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Tiranës. Pronarët që kanë gati lejet janë në 11 njësitë e kryeqytetit dhe në zonat përreth. Përfutuesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga AULIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfutuesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë

për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që

sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të

cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitën poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin,

nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë

takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese nëse pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

EMER	MBIEMER	NJESIA
ARDIAN	HYSA	2
DALIP	RAMA	4
JORGJI	JANULLARI	3
ASLLAN	META	7
ILUR	MULEKU	4
SOKOL	VATAJ	4
GIJIN	GIJINI	11
DYLBËR	YMERI	4
RUZHDI	KURMAKU	3
FATMIR	EBIP	4
HASAN	DAMZI	11
ALUSH	ZIRA	9
ALBAN,DEZDEMONA	BALLA,BALLA	11
SHEFKI	TAFA	9
HYSEN	KURTI	6
NEXHMI	HYSA	9
MARK	VUKZA	11
MÉRITA	SINA	4
FATMIR	SUSAJ	11
BAJRAM	PLAKU	6
LORETA	BEGANI	4
SINAN	KAZANI	4
ISMAIL	LLESHI	9
REXHEP	PAPA	4
XHAFAER,AZGAN,HALIL	MALIAJ,DEMALIAJ,DEMAL	11
AFRIM	ALIJAJ	6
ZEF	HASANAJ	11
LORETA	BEGANI	4
ERIND,NEVRAT	HASANLLARI,HASANLLARI	4
FATMIR,SONILA	CECOLLARI,CECOLLARI	11
MALIK,GAZMIR	LOCI,LOCI	9
FLORA,XHEZMI	LLAPANJ,LLAPANJ	4
LULEZIM	DURA	11
XHEZAR,PAJTIM	HYSLLARI,HYSLLARI	11
ARBEN	DURISHTI	4
MUSA	KABILLI	4
ZAIM	VESELI	11
NDUE	LLESHI	4
FASLLI,LUMTURIE	MERA,MERA	4
LUMTURIE	GURTHI	4
RAMAZAN	AJAZI	4
VLADIMIR	DAKE	3
SHEFIK	CAUSHI	9
MYFTEREM	QAMILI	2
ALI	RAMA	11
XHEVAT	ISLAMAJ	4
BESNIK	ALLA	11
JYSEN,PANAJOT,VALTER	CELLARI,CACELLARI,CACELI	3
ENGJELL	MATA	3
HYSNI	ALLA	1
PREKE	PERPERAJ	11
BAJRAM	SINANI	4
DRITAN	HOXHA	3
ZIJA	KASEMI	1
SELIM	METRA	4

FEHMI	GJANA	6
ARBEN	BIGA	4
EDUARD	GJONAJ	4
GEZIM	BRUCI	4
FATMIR,SEFEDIN	XHAMBASI,XHAMBASI	4
ARBEN,ARDIAN	SULAJ,SULAJ	11
BASHKIM,HASAN	ISMAILAJ,ISMAILAJ	9
PETRIT	MEMA	4
SHKELQIM	KAZANI	9
KUJTIM	MATOSHI	1
BUKURIE,HEKURAN	MANCILA,MANCILA	4
ESAT	REXHEPI	3
SHEFQET,ALI	MURATAJ,MURATAJ	11
FLAMUR	TOSKA	9
QAMIL	MANI	4
FIQIRI,BARDHYL	LULLA,LULLA	2
MIMOZA	ZYBERAJ	11
PERPARIM,RIZA	CANI,CANI	2
VIKTOR,GJOKE	VUKAJ,VUKAJ	4
EDUART	BALLA	4
AGIM	KRUJA	4
ALLAMAN,MENTOR,FESTIM	DOKU,DOKU,DOKU	11
ULVO,FJORELA,ENI,ALDO	BULLAJ,BULLAJ	3
FERIT	NDREGJONI	4
MAMUSH,ARDIAN	CUTARRAJ	4
KADRI	ALUSHI	11
IBRAHIM	LICI	7
VENDIM	HAJDARI	6
FADIL,SEIT,SPIRO	RAPCE	7
FEHIM,ARDIAN	MYRTOLLARI	1
FATMIR,RUDINA	PLAKU	11
QAMIL	NELI	3
SHKELQIM	GJUZI	4
HALIM	BRIJA	11
TUSHE	LLUPA	2
FEJZO	LAMA	8
HAMZA	LILA	9
SAIMIR	GJECI	4
ARJAN	SEJDINI	11
MAKSUDE,	SADA	9
MUSTAFA,ADRIAN,ALFRED	VELCANI	4
DYLBËR	ALIJAJ	4
NUREDIN	OSMANI	6
ILMI	BOSHKU	11
HYSEN	HOXHA	1
RAPI	MULLAMETI	11
ISA	MEMA	3
SELAM	ALLARAJ	9
BESNIK	PIPERI	7
NEVRUZ	NURA	4
QEMAL,MAKSI	STROKA,STROKA	3
SOKOL,GEZIM,AGIM,...	CUNI,CUNI,CUNI,...	11
KLAUDIO	HYSENBELLI	1
ARIFKE	ALLARAJ	9

ARBEN	MUCA	4
HEKURAN	LLAPUSHI	6
QEMAL	DOKA	4
besnik	cenI	4
muhamet,rexhep	LIKA	4
FERIT	BOSHKU	11
ARTA	DRICI(FASLLIA)	4
SHKELQIM	GJOKA	11
FESTIM	META	4
ENGJELL	DURO	7
RRAPUSH	LENA	2
BAHRI	ZYBERAJ	9
BASHKIM,HASAN	PIPERAJ	7
PERPARIM	XHEKA	11
ARBEN	ALLARAJ	9
AHMET	POPSHINI	4
AQIF	XHAFA	2
PJETER	DEMAJ	11
VEHBI	DALLIU	4
RUSTEM	RRUSHI	11
FATJON,HATIXHE	XHABAFTI	2
LUAN	SHEHU	11
NEVRUZ	SHEHU	8
YMERLI,BANDILL	PLAKU	11
RESMI	HOXHALLARI	9
LAVDERIM	HOXHA	9
NURI	UKA	9
DRITAN	DEMOLLARI	4
KRISTAQ,RAMADAN	NELI	3
ILIR	MANSAKU	11
PLLUMB	ALLARAJ	9
PETREF	MAHMUTI	11
ALBERT	ZEQQOLLARI	11
SHKELQIM	CELA	4
LEKE	MARTINI	11
AQIF	RRAFMANI	11
EMERLI	LITA	9
FIQIRI,BARDHYL	PLAKU	6
NAZMI	LACI	2
VANGJEL	LIKOLLARI	1
SULEJMAN,JANAQ	SULO,SULIOTI	6
FLORI	KACA	4
ANASTAS	HOXHA	4
ISMAIL	HAJRULLAI	4
PETRIT	URUCI	4
MUHAMET,SHKELQIM	TAHIRAJ	11
IMER	HITAJ	4
BEHAR	HOXHA	4
FATOS	ALLCIU	4
ARBEN	XHAFERRI	4
PASHK	MARKU	11
ASLLAN	BOGDANI	3
XHELAL	BEQIRI	4
SOKOL	COLLAKU	6

PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT

Table with 4 columns listing names and numbers. Includes names like EMER ATESI MBIEMER, ALEKSANDER ZEF MURRI, SABRI BAJRAM LUKAJ, DURIM BAJRAM SADIKILLARI, FATMIR SHABAN PAJTONI, and ASRITR SHERIF HYSA.

Operacioni në Kurbin, 11 të proceduar penalisht për tjetërsimin e pronave në mënyrë të paligjshme

Tokat, ish-punonjësit e Hipotekës në pranga

3 të arrestuar, 2 në kërkim, u përvetësuan 6.8 hektarë tokë

KURBIN

Forca e Ligjit" ka finalizuar operacionin e koduar "Hipoteka" në Kurbin ku në pranga kanë përfunduar ish-punonjësit të Hipotekës si dhe qytetarë përfitues të një sipërfaqjeje toke prej 6.8 ha, e përfutur me dokumente të falsifikuara. Numri i të proceduarve në total është 11 persona, ndërsa nga masat e arrestit me burg janë ekzekutuar vetëm tre, pasi dy të tjerë vijojnë të jenë në kërkim.

Janë arrestuar 3 shtetas me masë sigurie "Arrest me burg", janë shpallur në kërkim 2 shtetas me masë sigurie "Arrest me burg", janë proceduar në gjendje të lirë 4 shtetas, si dhe janë kryer veprimet për 2 të tjerë me masë sigurie "Arrest në shtëpi".

Si rezultat i tij, janë proceduar penalisht 11 shtetas (ish - punonjës pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin dhe qytetarë përfitues toke), të cilët, në bashkëpunim me njëri-tjetrin duke abuzuar me detyrën, kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 68120 m² tokë në Kurbin, pasi duke



qenë me detyrë si punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore, pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kurbin, kanë shpërdoruar detyrën, nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve që kanë për detyrë ta lëshojnë atë, nëpërmjet ndryshimit të zërit kadastrale, dhe pajisur me AMTP- persona të ndryshëm dhe regjistruar pranë Z.V.R.P.P Kurbin.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan certifikata të ndryshme pronësie,

akte të marrjes së tokës në pronësi, certifikata të ndryshme familjare, plane rilevimi, harta treguese për Rrethin e Kurbin.

Këto hetime proaktive, janë kryer në funksion të procedimit penal regjistruar në vitin 2017, për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës" "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 248-25-186/2 dhe 287/a/c të Kodit Penal.

Mbi bazën e provave të

grumbulluara dhe sekuestruara nga Seksioni për Hetimin e Krimit Ekonomik, Komisarjati i Policisë Kurbin dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykata e Shkallës së Parë Kurbin, me vendimin e datës 10 tetor 2018, ka vendosur masat e sigurisë për shtetasit e poshtëshënuar:

TË ARRESTUAR ME MASË SIGURIE "ARREST ME BURG"

1. Arben Sela, 50 vjeç, banues në Kurbin, përfitues toke, për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3 - 25 të Kodit Penal.

2. Ndue Gega, 55 vjeç, banues në Lezhë, me funksion hartograf pranë Z.V.R.P.P Kurbin, për veprën penale "Shpërdorim detyre", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 - 25 i Kodit Penal.

3. Bashkim Lika, 51 vjeç, banues në Kurbin, me funksion Kryetar Fshati në Fushë Mamurras, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 - 25 i Kodit Penal.

Të shpallur në kërkim me masë sigurie "Arrest me burg"

1. K.P. 46 vjeç, banues në Mamurras, për veprën penale "Shpërdorim detyre" kryer në bashkëpunim", parashikuar nga neni 248 - 25 i Kodit Penal.

2. H.A. 54 vjeç, lindur në Kurbin dhe banues në Tiranë, për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", kryer në bashkëpunim" parashikuar nga neni 248 - 25 i Kodit Penal.

ME MASË SIGURIE "ARREST SHTËPIE"

1. Gj.L. 76 vjeç, banues në Kurbin, me funksion ish - Kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokave në Mamurras, për veprën penale

OPERACIONI HIPOTEKA

TË ARRESTUAR ME MASË SIGURIE "ARREST ME BURG":

1. Arben Sela, 50 vjeç, banues në Kurbin, përfitues toke, për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 186/3 - 25 të Kodit Penal.

2. Ndue Gega, 55 vjeç, banues në Lezhë, me funksion hartograf pranë Z.V.R.P.P Kurbin, për veprën penale "Shpërdorim detyre", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 - 25 i Kodit Penal.

3. Bashkim Lika, 51 vjeç, banues në Kurbin, me funksion Kryetar Fshati në Fushë Mamurras, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 - 25 i Kodit Penal.

TË SHPALLUR NË KËRKIM ME MASË SIGURIE "ARREST ME BURG":

1. K.P. 46 vjeç, banues në Mamurras, për veprën penale "Shpërdorim detyre", kryer në bashkëpunim" parashikuar nga neni 248 - 25 i Kodit Penal.

2. H.A. 54 vjeç, lindur në Kurbin dhe banues në Tiranë, për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal.

ME MASË SIGURIE "ARREST SHTËPIE":

1. Gj.L. 76 vjeç, banues në Kurbin, me funksion ish - Kryetar i Komisionit të Ndarjes së Tokave në Mamurras, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim" "Shpërdorim detyre" "Pastrim i produkteve të veprës penale" parashikuar nga nenet 186/3, 248-25 dhe 287/1/a/c të Kodit Penal.

2. O.M. 69 vjeç, banues në Kurbin, me funksion ish - Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë në Bashkinë Mamurras, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, "Shpërdorim detyre", "Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 186/3, 248-25 dhe 287/1/a/c të Kodit Penal.

Gjithashtu, janë referuar materialet për procedim në gjendje të lirë në ngarkim të shtetasve:

1. M.A., Z.K., B.K. dhe G.SH., të dyshuar për veprat penale "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikimi i dokumentesh", si përfitues toke dhe punonjës me detyrë shtetërore. Punohet për kapjen e personave në kërkim, si dhe vazhdojnë hetimet për dokumentimin ligjor të personave të tjerë të implikuar.

"Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, "Shpërdorim detyre" "Pastrim i produkteve të veprës penale" parashikuar nga nenet 186/3, 248-25 dhe 287/1/a/c të Kodit Penal.

sisë në Bashkinë Mamurras, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", kryer në bashkëpunim, "Shpërdorim detyre", "Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 186/3, 248-25 dhe 287/1/a/c të Kodit Penal.

GJYQTARI

E akuzuan për votim të paligjshëm në KLD, Gjini Gjoni: Ja e vërteta

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, deklaroi gjatë një konference për shtyp se në mbledhjen e fundit, KLD i ka dhënë leje prindërore në mënyrë të fshehtë gjyqtarit Gjini Gjoni, me argumentin se është bërë baba dhe i duhet të udhëtojë drejt Gjermanisë atje ku jeton bashkëshortja e tij.

Etilda Gjonaj thotë se kërkesa është pranuar në mënyrë haptazi të paligjshme dhe është miratuar me votim nga anëtarët prezent të KLD-së po në mënyrë të paligjshme, duke mos pasur kuorumin e nevojshëm. "Kjo kërkesë e pranuar në mënyrë haptazi të paligjshme është miratuar me votim nga anëtarët prezent të KLD-së çka e bën shumicën e këtij institucioni autore të një vendimmarrjeje haptazi të paligjshme" Sipas Gjonajt vendimi është marrë në fshtësi, ndërsa akuzoi



Gjyqtari Gjini Gjoni

gjyqtarin Gjoni se ka votuar për veten e tij në mbledhje.

Nërkohë në një reagim për "News24", gjyqtari Gjini Gjoni shpreh se kërkesa e tij për leje prindërore është brenda kornizës ligjore, dhe se kuorumi për vendimmarrjen ka qenë i plotë.

"Kuorumi për vendimmarrjen ka qenë i plotë dhe nuk është e vërtetë që votova për veten time. Nuk është

hera e parë që KLD miraton leje të kësaj natyre" u shpreh gjyqtari Gjoni për "News24", ndërsa tha se ministrja e Drejtësisë nuk ishte e pranishme në mbledhje. Ndër të tjera Gjoni e konsideroi deklaratën e ministres Gjonaj si nonsens dhe të pazabë. "Leja prindërore nuk e përjashton dhe nuk e shtyn vetëingun", u shpreh gjyqtari Gjini Gjoni.

BOTIMI


Rrëfimet e të mbijetuarve të komunizmit në një botim

Fatmira Nikolli


Shqipëria është e vogël për të parë, po edhe për të qarë", kjo frazë e thjeshtë e znj. Gjelijë Gjikota, e mbijetuar e Kampit të Tepelenës, flet më shumë se qindra faqe diskutimesh pa bërëqet që na vijjnë nga diskursi politik i ditës. Ne të gjithë, si njerëz të lirë, duhet të kërkojmë së bashku të vërtetën duke krijuar marrëdhënie të tjera besimi me njeri-tjetrin. Liria ekziston në masën ku të gjithë janë të lirë. Nga përmbajtja e kujtimeve tona, mënyra se si ne kujtojmë dhe ajo që ne do të zgjedhim si ideal, e gjitha kjo do të ndikojë në zgjedhjen tonë se si do të bëhemi. Por, të kujtuarit nuk është i mjaftueshëm. Në sajë të kujtimeve ne do të njohim atë se çfarë duhet të bëjmë sot. Prof. Dr. Gjergj Sinani ndalet gjatë të raportit ynë me kujtesën e me lirinë në botimin me rrëfimet e të mbijetuarve të komunizmit.

"Tregimi im, është detyrim moral për prindërit e mi, për veten time, për ju o bij, për bashkëvuajtësit e mi dhe për shoqërinë", thotë një i mbijetuar i diktaturës. Historitë e rrëfyera në këtë botim hapin faqe të historive personale që premtojnë dhimbje, lot e vuajtje. Por dialogu shoqëror që synojmë të edukojmë e zhvillojmë për të shkuarën mund të realizohet vetëm nëpërmjet kësaj hapjeje e dokumentimi. Sepse është përballja me të vërtetën ajo që e çon shoqërinë drejt shërimit dhe rivendosjes ekuilibrit. Kjo përballje nënkupton edhe zbardhjen e fatëve të të pafajshmëve dhe nderimin i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor, duke njohur përjetimet e tyre, përmes zërave të tyre. Ky është hapi i rëndësishëm që hedhim sot". Një tekst hyrës nga Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Sigurimit të Shtetit, të vë para një prezantimi të menjëhershëm të gjendjes që krijohet tekta shfleton. Sula vëren se EDHE MURET KANË VESHË u titullua platforma e rrëfimeve të mbledhura nga AIDSSH, me historitë e mbledhura me kujdes dhe përgjegjësi, përmes zërave të padëgjuar, AIDSSH i jep një shans në shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes së papenguar në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në diktaturë. Metodologjia e EDHE MURET KANË VESHË u zhvillua në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të Shëruar dhe Parandaluar", i zbatuar nga AIDSSH, me mbështetjen e UNDP Shqipëri dhe qeverisë së Italisë, të cilët mbështetën edhe këtë botim të parë të kësaj kolane. I falënderojmë për mbështetjen! Botimi i parë përmbledh dëshmitë e të mbijetuarve të Kampit të Internimit në Tepelenë 1949-1953. Ky botim do të ndiqet nga dëshmi të tjera të të mbijetuarve,

"Termet 'bashkëfajtorë' apo 'të paanshëm' si duhen përdorur saktë shkencërisht dhe si janë përdorur shpesh abuzivisht"



dhe nga dëshmitë e tepelenasve bashkëkohës të kampit, duke synuar përshkrimin e përjetimeve të tyre në bashkëjetesën e detyruar me të internuarit e asaj periudhe. NJË QASJE MBI LIRINË Prof. Dr. Gjergj Sinani vëren në parathënieën e librit se ndarja e pushteteve, liria e shtypit, njohja e pronës private dhe mbrojtja e saj me ligj si dhe zhvillimi i një shoqërie civile, janë disa nga mjetet që mund të përdoren me efektivitet të lartë për të realizuar qëllimet e mësipërme. Sinani shton se në funksion të këtyre qëllimeve është edhe zbulimi, mbledhja e dëshmimeve të njerëzve që përjetuan dhunën dhe terrorin totalitar komunist 45-vjeçar, që sakrifikuan jetën, rininë e tyre goftë për shkak të ideve dhe akteve vetjake, goftë për shkak të lidhjeve familjare, njohja me kalvarin e jetës, qëndresa e atyre që kaluan nga ferri i Maliqit, Tepelenës, Spaçit, etj. dhe bërja publike e tyre. Rënia në kontakt me këto dëshmi ka impakt të drejtpërdrejtë transformues të vetëdijes njerëzore, sepse nuk ka qenie njerëzore të mos krijojë respekt dhe nderim për cilindo vuajtje të asaj diktature, pasi të lexojë dhe njohë këto dëshmi, nuk ka qenie njerëzore të mos ndryshojë mendësi e këndvështrim për të kaluarën, që tjetër i ishte paraqitur dhe tjetër ishte realisht.



Libri përmbledh rrëfimet e të mbijetuarve të Kampit të Internimit në Tepelenë 1949-1953. Ky botim do të ndiqet nga dëshmi të tjera të të mbijetuarve, si dhe nga dëshmitë e tepelenasve bashkëkohës të kampit, duke synuar përshkrimin e përjetimeve të tyre

E keqja e një individi dhe është e vështirë të zhbëhet, po ajo e një regjimi të tërë të organizuar në të gjitha strukturat dhe instrumentet e tij? Aq më keq me një jetëgjatësi 45-vjeçare?

Sipas prod. Dr. Gjergj Sinanit në debatin rreth shkrimit të një "historie zyrtare" dhe konkurrencës që po i bën kujtesa, është e domosdoshme që të tregohen dallimet dhe ndikimet reciproke. Ku qëndrojnë dallimet dhe konvergencat ndërmjet historisë dhe kujtesës? A ka një detyrë të kujtesës? Cili duhet të jetë roli i historianit në debatet shoqërore rreth historisë dhe kujtesës? "Termet 'bashkëfajtorë' apo 'të paanshëm' si duhen përdorur saktë shkencërisht dhe si janë përdorur shpesh abuzivisht nga politika për të justifikuar krimin komunist, mbuluar përgjegjësit dhe penguar drejtësinë që të kryejë procese të rregullta ndaj tyre? Ka edhe shumë pyetje të tjera të cilat nuk mund të zgjidhen nga baza të thjeshta empirike, por kërkojnë padyshim njohje të thellë të proceseve historike, njohje të vlerave njerëzore dhe metodën e duhur për të ndërtuar diskutimin, analizën dhe vlerësimin sa më saktë e sa më mire", pyet profesori.

Për të, historia dhe kujtesa janë dy fusha të ndryshme; çdo njeri ka kujtesën e vet, me kujtime të mira apo të këqija; kujtesa ruan gjurma të të kaluarës, të brendësuar, të shkrira në identitetin tonë. Në nivelin individual nuk ka kurrë dy kujtime identike. Por, kujtesa është edhe kolektive, që krijohet nga shumë individë, por edhe ajo është gjithnjë nën ndikimin e asaj të tashmeje kur krijohet.

Ministri i Jashtëm në Prishtinë: Ne presim që t'i ekstradojnë ata

Apeli i Turqisë: Kosova të dëbojë pjesëtarët e organizatës "FETO"

Çavusoglu: Të ruhet integriteti territorial

Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavusoglu u ka kërkuar autoriteteve kosovare kthimin në Turqi të pjesëtarëve të organizatës "Feto", që Turqia e cilëson si organizatë terroriste. Të premtën në orë e vona, ministri i Jashtëm i Turqisë u prit në Prishtinë fillimisht nga ministri i Jashtëm i Kosovës, Behxhet Pacolli dhe më pas edhe nga Presidenti Hashim Thaçi. Dy zyrtarët e lartë të Kosovës nuk folën për kërkesën e Turqisë, por ishte vetë Çavusoglu, i cili ka thënë se Kosova nuk duhet të lejojë shtrirjen e veprimtarisë së organizatës "Feto", në Kosovë.

"Ne presim që t'i ekstradojnë ata"

"Ne nuk duam që Kosova t'i lejojë terroristët, të cilët kanë bërë puç në Turqi të jetojnë këtu. Ne presim që t'i ekstradojnë ata. Ne ata i konsiderojmë të rrezikshëm për Turqinë dhe sigurinë e Kosovës. Ne nuk do të lejonim që dikush në Turqi të bënte ndonjë veprimtari ilegale për Kosovën e lëre më ndonjë puç. Ne do t'i dorëzonim në Kosovë të gjithë ata që do të tentonin diçka të tillë", është shprehur ministri i Jashtëm turk Mevlüt Çavusoglu.

Të njëjtën kërkesë shefi i diplomacisë turke e bëri edhe për qeverinë e Shqipërisë gjatë vizitës që zhvilloi të njëjtën ditë atje.

"Në Shqipëri ka një strukturë fetoiste tepër serioze të shtrirë në të gjitha fushat. Si dhe në vendet e tjera. Ata kanë përdorur sistemin arsimor dhe kanë depërtuar në sistemin shtetëror. Turqia pret që të mbyllin institucionet që zhvillojnë veprimtari antiturke në Shqipëri", citojnë mediat në Shqipëri Çavusoglu.

Arrestimi i 6 qytetarëve turq

Në 29 mars të këtij viti, ndërkaq, policia e Kosovës pati arrestuar dhe dëbuar

DISKUTIMET
Dy zyrtarët e lartë të Kosovës nuk folën për kërkesën e Turqisë, por ishte vetë Çavusoglu, i cili ka thënë se Kosova nuk duhet të lejojë shtrirjen e veprimtarisë së organizatës "Feto", në Kosovë.
"Ne presim që t'i ekstradojnë ata"
"Ne nuk duam që Kosova t'i lejojë terroristët, të cilët kanë bërë puç në Turqi të jetojnë këtu.



Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavusoglu

HASHIM THAÇI

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se "Kosova po kërkon të arrijë marrëveshje paqësore me Serbinë, që do të hapë perspektivë evropiane për të dy vendet. Marrëveshja është në interes të të dyja vendeve", ka thënë Presidenti Thaçi pas takimit me ministrin e Jashtëm të Turqisë.

ARRESTIMET

Në 29 mars të këtij viti, ndërkaq, policia e Kosovës pati arrestuar dhe dëbuar për në Turqi gjashtë qytetarë turq. Pesë prej tyre ishin punonjës në rrjetin e shkollave "Mehmet Akif". Lëvizja e Gylenit ka gjithsej katër shkolla në gjithë Kosovën. Shkollat "Mehmet Akif" ku punonin gjashtë shtetasit e Turqisë, janë të shtrira në disa qytete të Kosovës dhe i përkasin Institucionit Arsimor turk "Gylistan". Zyrtarët e Ministrisë së Arsimit të Kosovës disa herë kanë deklaruar se këto institucione shkollore, vepron në përputhje me ligjet e Kosovës.

Gylistan, në Kosovë ka edhe kopshte fëmijësh, institucione parashkollore e shkolla fillore dhe të mesme pothuaj në të gjithë Kosovën.
Arrestimi dhe dëbimi i gjashtë turqve për në Turqi, pati ngritur debat të ashpër në skenën politike kosovare. Kryeministri dhe

punonjës në Kolegjin Mehmet Akif, të akredituar sipas standardeve përkatëse të Kosovës, nuk përfaqëson as formën e duhur të zhvillimit të sundimit të ligjit, as konsolidimit të nevojshëm të demokracisë. Ndërmarrja e veprimeve të tilla pa respektim të procedurave përkatëse dhe mungesë transparence lë hapësirë të theksuar për mëdyshje për veprimet arbitrare të autoriteteve në fjalë", pati deklaruar Kadri Veseli. E rasti i arrestimit të procedurave brenda ditës i gjashtë shtetasve turq, bëri që të japin dorëheqje ministri i Punëve të Brendshme dhe shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Turqia mbështet dialogun Kosovë-Serbi

Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë Mevlüt Çavusoglu, gjatë qëndrimit në Prishtinë, ndër të tjera u shpreh edhe rreth dialogut Kosovë-Serbi. Ai tha se Turqia e mbështet këtë dialog duke potencuar faktin që Turqia i kushton një rëndësi të madhe stabilitetit dhe paqes në rajon. "Ne me popullin e Kosovës kemi lidhje historike dhe integriteti

Turqia e mbështet këtë dialog duke potencuar faktin që Turqia i kushton një rëndësi të madhe stabilitetit dhe paqes në rajon. "Ne me popullin e Kosovës kemi lidhje historike dhe integriteti territorial i Kosovës është bazë për ne. Ne do të bisedojmë edhe me vendet që nuk e kanë njohur Kosovën. Për integrimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare jemi duke u angazhuar.

territorial i Kosovës është bazë për ne. Ne do të bisedojmë edhe me vendet që nuk e kanë njohur Kosovën. Për integrimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare jemi duke u angazhuar. Kemi arritje të mëdha, ne e mbështesim edhe dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit dhe paqen e konsiderojmë të rëndësishme", u shpreh Çavusoglu.

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k. propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjese Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** në sallën e takimeve tek **"Grand Hotel Korça"**

kryetari i Kuvendit të Kosovës ishin kundër këtij dëbimi dhe kjo nodhi, siç thanë ata, "pa dijeninë e tyre". Arrestimi i sotëm i gjashtë shtetasve turq, banorë me leje të vlefshme qëndrimi në Kosovë dhe



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbares Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 09.11.2018 8 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shitjen e pasurisë të paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 6/90, volumni 9, faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankand 17.640 (Shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



“Lutja” e GAZMEND LEKËS, një grishje për lutje e gjithë shoqërisë

NGA BEN ANDONI

Viti 1991. Kroatët luftojnë me mjetet e fundit kundër makinerisë së stërmadhe ushtarake serbe. Anipse besimi, forca dhe dashuria për atdheun nuk mjaftojnë. Atëherë, dikujt i shkon në mend një gjetje e jashtëzakonshme. Në sheshin kryesor të qytetit thirren për çdo natë të luten, të gjithë qytetarët. Dhe, kështu ndodh. Në një orë të caktuar të mbrëmjes, e cila koincidon me momentin e agresionit të ish-popullit vëlla, kroatët të gjithë luten. Po, po luten. Pleq, të rinj, gra dhe burra. Më pak të rinj. Këta të fundit janë thirrur nën armë. Me ungitë në dorë, çdokush që e ndjente veten kroat lutej. Për çfarë? Për atdheun! Për tokën! Për shtëpinë! Fëmijët, që kanë shkuar në luftë! Bukën! Gjithçka...Si i huaj, mes turmës që shndrit me qirinj, më mbet ndërmend një nga pak momentet e singërta sesi një popull i bën mirëseardhjen agut të së ardhmes. Lutja është pragu i lirisë, që pakkush e di me siguri se do vijë. Lutja ishte shpresë...Mbase edhe fund. Por, lutja është lutje...

Me rastin e 80-vjetorit të botimit

Historia e panjohur e “Kangës së Gjorq Golemit, Princit të Sopotit”

Në vitin 1938 zoti Shahin Zharri (1915-1991) nga Bërzeshta e Li brazhdit, botoi në revistën “Shkolla Kombtare” (Nr. 16-17, faqe 22) këngën historike me titull: “Kanga e Gjorq Golemit, Princit të Sopotit”¹⁾ e cila i kushtojë një prej figurave më të shquara historike të shekullit të 15-të,

Princit Gjergj Aranit Komnen Golemi. Zotit të Çermenikës, Mokrës dhe Sapatit.²⁾

Shahin Zharri, ende nxënës në klasën e shtatë të shkollës Normale të Elbasanit, mblodhi në fshatin e tij të lindjes, në Bërzeshtë, disa krijime folklorike dhe ndërmjet tyre këngën e Princit të Sopotit, e cila, pas botimit, do të bëhej menjëherë e famëshme. Që nga botimi i saj në vitin 1938, për gati 80 vjet,

kënga e Gjorq Golemit ka pasur një njohje dhe përhapje të jashtëzakonshme, si rrallë në folkloristikën shqiptare, e cila është radhitur si një ndër krijimet më të bukura të folklorit shqiptar. Ajo ka shëbyer si frymëzim për shumë krijues, shkrimtarë dhe artistë shqiptarë, të cilët kanë realizuar vepra dinjitoze në krijimtarinë letraro-artistike, si: poezi (vjersha, poema), prozë (novele, tregime, librete, dramatzime),

muzikë (opera), arte pamore (grafika, piktura, skulptura) etj.

Kënga e Gjorq Golemit dhe Shahin Zharri (si mbledhësi dhe botuesi i parë i saj) kanë marrë vlerësime nga studiuesit dhe personalitet më të larta të letërsisë dhe folklorit shqiptar. Prof. Dr. Akademik Dhimitër S. Shuteriqi, shkrimtar dhe studiues i mirënjohur, në lidhje me mbledhjen dhe botimin e këngës në fjalë, ka shkruar se “Shahin Zharri pati fatin e rrallë të mblidhte “Kangën e Gjorq Golemit”, se pa të kënga do të kishte humbur...³⁾ Po të ishte gjallë sot Shahin Zharri, për këngën e Gjorq Golemit, që e shpëtoi, se pa (a) të kënga do të ishte zhdukur, ne mikun tonë të dashur do ta uronim: Të këndoftë zemra përherë! Zemra atij përherë i këndon me këtë këngë, sepse ai e botoi dhe e bëri të paharrueshme”.

→Vijon në faqen 14

F

FOLKLOR

NGA AVNIALCANI

Kurse studiuesi i njohur i folklorit shqiptar, Prof. Dr. Agron Xhagolli, shkruan: "Historia e shoqërisë njerëzore dëshmon se ka ngjarje, momente apo publikime që përcjellin vlera të përmasave që dalin nga kuadri i jetës së zakonshme. Një tekst kënge folklorike rregjistroi dhe botoi me emrin e tij Shahin Zharri (nga Bërzeshta e Librazhdit), dhe e bëri atë të njohur, duke e lartësuar për gjithë jetën e tij, pasi ajo këngë ishte e veçantë për nga rëndësia, për mbarë folkloristikën shqiptare dhe më gjërë... Shahin Zharri ka hyrë tashmë në historinë e folkloristikës shqiptare, jo thjeshtë si mbledhës i folklorit në një moshë shumë të re, por, mbi të gjitha, si mbledhës dhe publikuesi i një prej krijimeve folklorike shqiptare, kushtuar një figure historike nga më të hershmet, që na e sjell deri më sot epika historike shqiptare. Kuptohet se sa e paçmuar është ndihmesa e këtij mbledhësi aq të ri në moshë..."⁹ Prof. Dr. Akademik Shaban Sinani shkruan: "Kënga e Gjorg Golemit ruan gjurma lidhesh artistike me ciklin e Skënderbeut, kjo do të thotë se hershmëria e krijimit të saj mund të jetë absolute, në kuptimin që ajo mund të ketë lindur bashkë me ngjarjen".¹⁰

Kënga e Gjorg Golemit dhe pasqyrimi i figurës së Gjergj Aranitit në letërsi dhe arte kanë qenë objekt studimi i autorit të këtij shkrimi,¹¹ një fragmendi të së cilit po e radosim më poshtë:

"KËNGA E GJ. GOLEMIT DHE FIGURA E GJERGJ ARANITIT NË LETËRSI DHE ARTE"

Në vitet '60, veçanërisht në prag të 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gj. K. Skenderbeut, shumë shkrimtarë dhe artistë shqiptarë i kthyen sytë nga e kaluara historike e popullit shqiptar, veçanërisht në ngjarjet e mëdha të shekullit XV, të quajtur epoka skënderbeje, dhe shkruan vepra të rëndësishme që kishin si subjekt ngjarjet dhe figurat historike më të spikatuara shqiptare. Disa nga shkrimtarët dhe artistët më të njohur, si Dhimitër Shuteriqi, Sterio Spasse, Koçi Petriti, Dilaver Baxhaku, Musa Vyshka, Odhise Grillo, Kolë Jakova, Nikolla Zoraqi, Odhise Paskali, Dhimitër Çani, Guri Madhi, Sali Shijaku, Pandi Mele, Sami Roçi, Agim Rada, Lulzim Mema etj., krijuan vepra nga motivet e këngës së Gjorg Golemit, si dhe pasqyruan në këto vepra figurën e Gjergj Aranitit (Gjorg Golemit), duke realizuar vepra dinjitoze në letërsi dhe në arte, si romane, novela, tregime, drama, opera, vjersha, poema, piktura, skulptura etj.

Krijimi i parë letrar që njohim, i cili është shkruar me motive të këngës sotate, është novela "Ditët e sprasme të Gjorg Golemit: Lufta e Bekuar" (1959).⁹ Novela është vepër e shkrimtari Dhimitër Shuteriqi. Ngjarjet dhe personazhet e novelës mbështeten në motivet e këngës së Gjorg Golemit. Novela pati sukses dhe u prit mjaft mirë nga lexuesit. Kritika e kohës e cilësoi novelën e D. Shuteriqit si një nga "krijimet më të bukura... (që) edhe tani ajo lexohet me endje..."⁹

Shkrimtari Sterjo Spasse romanin e tij epope "Pishtarët" (1975), ia ka kushtuar lëvizjes kombëtare shqiptare për liri dhe pavarësi. Një nga personazhet e romanit,

Autori rrëfen historinë sesi në vitin 1938 zoti Shahin Zharri (1915-1991) nga Bërzeshta e Librazhdit, botoi në revistën "Shkolla Kombtare" këngën historike me titull: "Kanga e Gjorg Golemit, Princit të Sopotit", e cila i kushtohet një prej figurave më të shquara historike të shekullit të 15-të, Princit Gjergj Aranit Komnen Golemi, Zotit të Çermenikës, Mokrës dhe Shpatit...

Me rastin e 80-vjetorit të botimit

"Kanga e Gjorg Golemit, Princit të Sopotit"



Halit Bërzeshta (Bej Babai), gjatë meditimeve i ulur mbi minderin e shtëpisë së tij, kujtonte legjendën e Gjorg Golemit dhe heroizmin e grave sotate.

Në novelën "Prilli i thyer" (1978), e shkrimtarit Ismail Kadare, personazhi kryesor i saj e ka emrin Gjorg. Kemi mendimin se emri Gjorg, i novelës së Kadaresë, është huazuar nga emri i personazhit kryesor të poemës së mirënjohur sotate, Gjorg Golemit. Gjuhësisht, forma e emrit Gjorg-Gjorgu, është varianti i emrit bibliik Gjergj. Variantet: Gjorg, Gjorga, Gjorgu, qarkullon vetëm në trevat e Librazhdit, nga ka dalë edhe kënga e Gjorg Golemit dhe ky emër (Gjorg) nuk është i rëndomtë në viset e tjera shqiptare. Emrin Gjorg, Gjorgë, Gjorga e ndeshim edhe sot në disa toponime. Në Polis dhe Sopot, një pjesë e malit të Polisit thirret: Mali i Gjorg Golemit. Në Myzeqenë e Vogël (Elbasan) Gjorgë quhet gryka ku kalon një përrua. Në fshatin Gurakuq (Çermenikë) ndodhet një fis i tërë që mban si mbiemër (llagap) emrin Gjorga etj.

Në vitin 1967, poeti i mirënjohur

Kënga e Gjorg Golemit

Në vitet '60, veçanërisht në prag të 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gj. K. Skenderbeut, shumë shkrimtarë dhe artistë shqiptarë i kthyen sytë nga e kaluara historike e popullit shqiptar, veçanërisht në ngjarjet e mëdha të shekullit XV, të quajtur epoka skënderbeje, dhe shkruan vepra të rëndësishme që kishin si subjekt ngjarjet dhe figurat historike më të spikatuara shqiptare. Disa nga shkrimtarët dhe artistët më të njohur, si Dhimitër Shuteriqi, Sterio Spasse, Koçi Petriti, Dilaver Baxhaku, Musa Vyshka, Odhise Grillo, Kolë Jakova, Nikolla Zoraqi, Odhise Paskali, Dhimitër Çani, Guri Madhi, Sali Shijaku, Pandi Mele, Sami Roçi, Agim Rada, Lulzim Mema etj., krijuan vepra nga motivet e këngës së Gjorg Golemit, si dhe pasqyruan në këto vepra figurën e Gjergj Aranitit (Gjorg Golemit), duke realizuar vepra dinjitoze në letërsi dhe në arte, si romane, novela, tregime, drama, opera, vjersha, poema, piktura, skulptura etj.

ishte e titulluar: "Antalogji për Skënderbeun" (1967). Në të ishin përfshirë krijimtaria më e mirë letrare e autorëve shqiptarë në vite.

Eventimenti më i veçantë letrar dhe artistik ishte libreti i operës "I fundmi i Golemëve" (1968). Vepra e kishte marrë motivin dhe frymëzimin nga kënga e Gjorg Golemit. Ajo u shkruar nga shkrimtari i mirënjohur Kolë Jakova. Libreti shërbeu për t'u shkruar një opera nga kompozitori Nikolla Zoraqi. Opera u shkrua me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, por, për fat të keq, kjo vepër nuk u vu në kurrë në skenën shqiptare, për shkak të mentaliteteve të kohës, të pretendimit absurd, se personazhi kryesor i vepërës ishte një prift (!).

Figurën e Princit të Sopotit e pati përfshirë në vepërën e tij dhe poeti Koçi Petriti. Petriti ka qenë mësues në trevat e Librazhdit prej shumë vitesh dhe i ishte dhënë mundësia të ishte në kontakt dhe të njihje me krijimtarinë folklorike librazhdase kushtuar Gj. Golemit. I mbështetur të këto legjenda ai shkroi baladën "Golomarja" (1974). Disa vite më vonë ai e ripunoi baladën dhe i shtoi vjershës vargje të tjera, duke e transformuar në një poemë. Në vitin 1978, në kuadër të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, poema e K. Petritit "Golomarja" mori Çmimin e Parë Kombëtar.

Mbështetur në subjektin e këngës së Gjorg Golemit, shkrimtari Dilaver Baxhaku shkroi një dramë, të titulluar "Histori me rrënjët në legjendë-Historia e kalasë së Sopotit dhe e Gjergj Golemit" (1982).¹⁰ Drama u realizua në vitin 1982 si radiodramatizim. Ajo u regjistruar në Radio-Tirana nga një grup aktorësh të Teatrit Popullor të Tiranës. Radiodramatizimi "Histori me rrënjët në legjendë..." është transmetuar disa herë në emisionin e Radio-Tiranës: "Heroizmi i popullit tonë në shekuj".

Shkrimtari i mirënjohur për fëmijë, Odhise K. Grillo, shkroi një libër poetik me ilustrime, të titulluar: "Shpata e Gjorg Golemit" (2001). Subjekti i librit autori e mori nga legjenda dhe nga kënga e Gjorg Golemit, duke e përshtatur këngën dhe legjendën e Gjorg Golemit për fëmijë. Libri është ilustruar nga piktori Lulzim Mema.

Krijimi më i fundit letrar, që ka si personazh kryesor një Arianit Komneni, është romani i autorit Ben Blushi: "Të jetosh në ishull" (2008). Personazhi i B. Blushit ka jetuar në shek. XVII dhe është stërnip i nipit të Gjergj Aranit Komnenit, princit të famshëm shqiptar të shek. XV, emrin e të cilit e ka trashëguar ai dhe djali i tij, Gjergji. Në hyrje të romanit, Arianit Komneni i rrëfen Ali Tepelenës, një tjetër personazhi historik, rrënjët e fisit të tij të Komnenëve dhe historinë e bëmat e stërgjyshit të tij të madh.

* * *

Figurës së Gjergj Aranitit i janë kushtuar mjaft vepra në artet figurative, si në pikturë, skulpturë, grafikë, qeramikë etj.

Me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut piktori Pandi Mele ka realizuar një portret në grafikë kushtuar figurës së Gjergj Aranitit. Portreti i P. Me-



elbasanas Musa Vyshka, botoi një vjershtë të titulluar "Gjorg Golemi". Vjersha u botua në një antologji letrare, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, e cila

les ilustron çdo shkrim kushtuar Gj. Aranitit. Gjithashtu, po në këtë kuadër, piktori Guri Madhi realizoi në pikturë kompozimin e titulluar "Sopotaret". Tabloja evidenton heroizmin dhe vetëmohimin e grave sotate, të cilat rrëmbyen armët në mbrojtje të Gjon Golemit dhe të kështjellës së Sopotit. Piktura është mjaft e realizuar artistikisht dhe konsiderohet si një nga veprat më të bukura të piktorit Guri Madhi. Piktori librazhdas Sami Roçi, i frymëzuar në këngën e legjendën e Gjon Golemit, mbështetur dhe nga poema "Golomarja" e Koçi Petritit, në vitin 1978 realizoi një pikturë shumë të bukur kushtuar Marës së Golemëve. Portreti i parë që njohim në skulpturë, kushtuar Gjergj Aranitit, është një vepër e Dhimitër Çanit, e realizuar në kuadrin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Në vitin 1981 skulptori Agim Rada realizoi një portret kushtuar Gjergj Aranit. Portreti ndodhet në muzeun Gjegj Kastrioti-Skënderbeu të qytetit të Krutës.

Portreti më i bukur në skulpturë, kushtuar figurës së Gjergj Aranitit, është realizuar në vitin 1983 nga klasiku i skulpturës shqiptare, Odhise Paskali. Portreti i Paskalit kohët e fundit (2005) është derdhur në bronz dhe është vendosur në sheshin kryesor të qytetit të Librazhdit.

Piktori Sali Shijaku ka realizuar mbi një pjatë dekorative në qeramikë portretin e Gjon Golemit, të cilin e pat titulluar: "Në Mal-Plak, mbi një breg, Gjon Golemi thotë jam Mbret!". Titulli është marrë nga vargjet e këngës së Gjon Golemit. Pjata dekorative ishte koleksion i një ekspozite me punime qeramike, që piktori Shijaku kishte hapur në vitin 1985 në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative të Tiranës.

Në vitin 2001 piktori Luzlim Mema ilustron librin e sipërmendur "Shpata e Gjon Golemit" të shkrimtarit Odhise Grillo. Piktori Mema ka realizuar rreth 16 ilustrime me ngjyra (kompozime), duke përfshirë edhe dy kopertinat. Piktori, për t'i vendosur ngjarjet në kohë, në shek. e 15-të, ka përdorur mjete dhe elemente artistike shumë shprehëse, si veshjet, armët e luftëtarëve shqiptarë, kështjellën, paisazhin etj., të cilat nxisin dhe zhvillojnë fantazinë e fëmijëve. Ilustrimet janë mjaft të arrira nga ana artistike.

Kënga e Gjon Golemit ka qenë dhe mbetet objekt edhe i krijimtarisë publicistike. Në shtypin shqiptar janë shkruar me dhjetra artikuj, që i kushtohen ngjarjes së Sopotit dhe figurës së Gjon Golemit.¹⁾

Duke u nisur nga fama që kishte kënga e Gjon Golemit, nga vargjet e këngës, që u bënin thirrje grave sotate në mbrojtje të Sopotit, mjaft nga vargjet e këngës së Sopotit janë deklamuar nëpër konferenca dhe tribuna kongresesh.²⁾

- 1) Zharrri 1988 : faqe 22;
- 2) "Zonja Maria e larqepërmendur, motër e tim eti, pati për burrë Zot Aranit Komnenin, që ishte Zoti i Cermenikës (Cermenica) dhe i Mokris (Mochino) dhe i Shpatit (Spentia)", "Muzaka 1996: faqe 19;
- 3) Shuteriqi 1997: Gazeta "Dita informacion";
- 4) Shuteriqi 2007: "Gazeta Shqiptare";
- 5) Xhagolli 2005: faqe 3;
- 6) Sinani 2004: faqe 90;
- 7) Alcani 2010 : faqe 203-241;
- 8) Shuteriqi 1957 : faqe 26 - 70 ;
- 9) Shapllio 2004: faqe 96;
- 10) Baxhaku 1982: Fondi i fonotekës së Radio-Tiranës, Nr. i regjistrimit 559, 1982;
- 11) Alcani 2006: faqe 74;
- 12) Po aty, faqe 74-75;

Bibliografia:

- Alcani 2006:** Alcani, Avni. *Shahin Zharrri* (1915-1991) Monografi, Tiranë 2006;
- Alcani 2010:** Alcani, Avni. *Shahin Zharrri dhe Kënga e Gjon Golemit*, "Çështje të folklorit shqiptar", Nr. 10, 2010 (Botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Departamenti i Folklorit);
- Baxhaku 1982:** Baxhaku, Dillaver. *Histori me rronjë në legjendë - Historia e kalasë së Sopotit dhe Gjon Golemit*, 1982. Radiodramatizim (Fondi i fonotekës së Radio-Tiranës, Nr. i regjistrimit 559), Tiranë 1982;
- Muzaka 1996:** Muzaka, Gjon. "Memorie" (Botim shqip), Tiranë 1996;
- Sinani 2004:** Sinani, Shaban. *Kënga e Gjon Golemit dhe cikllin i Skënderbeut*. Cermenika: Përmblidhje studimesh, Nr. 1, Tiranë 2004;
- Shapllio 2004:** Shapllio, Dalan. "Në botën krijuese të një tregimtarit të shquar", "Nëdim Dh. S. Shuteriqit", Tiranë 2004;
- Shuteriqi 1967:** Shuteriqi, Dhimitër. "Ditët e sprasme të Gjon Golemit: Lufta e Bokuar", Revista "Njëtori", Nr. 3, Tiranë 1967;
- Shuteriqi 1997:** Shuteriqi, Dhimitër. *Duke marrë shkas nga një këngë historike 11*, Gazeta "Dita informacion", dt. 5-6.02.1997;
- Shuteriqi 2007:** Shuteriqi, Dhimitër. "Kënga e Gjon Golemit dhe legjendën dhe historinë" (Referat i mbajtur në Sesionin shkencor kushtuar 60 vjetorit të botimit të "Këngës së Gjon Golemit"), "Gazeta shqiptare", datë 10 qershor 2007;
- Xhagolli 2006:** Xhagolli, Agron. Parathënie e librit "Shahin Zharrri", Monografi, 2006;
- Zharrri 1988:** Zharrri, Shahin. "Kënga e Gjon Golemit, Princit të Sopotit", Rev. Shkollë Kombtare, Nr. 16-17, Tiranë 1988;

L

LAJM

Dy studiues shqiptarë përfaqësojnë vendin në panairin e Podgoricës

NGA STAFF "MILASO"

Shkrimtari dhe studiuesi Arian Leka dhe përkthyesja dhe studiuesja Silvana Leka marrin pjesë në Panairin e Ndërkombëtar të Librit në Mal të Zi. Ky panair me rëndësi në aspektin rajonal - i cili këtë vit i zgjerohet edhe më shumë dimensionet, duke pasqyruar të ftuar veç Ballkanit edhe shkrimtarë, ilustrues librash, kritikë letrare, studiues dhe botues nga Gjermania, Skocia, Irlanda etj - u zhvillua këto ditë në Capital Plaza - Podgoricë dhe në ditën e dytë të veprimtarive i kushtoi një hapësirë të veçantë diskutimesh, debatesh dhe promovimesh letërsisë për të rinj dhe fëmijë.

Përveç paraqitjes me një stand të veçantë të publikimeve të "Botime POETEKA", Silvana Leka dhe Arian Leka u bënë pjesë e veprimtarive të seminarit dhe tryezës së rrumbullakët të njëjës nga temat më të mprehta të sotme, atë të letërsisë për fëmijë dhe të rinj, lexuesit të ri dhe formave alternative dhe klasike në leximtarë, në të cilat pjesëmarrësit diskutuan edhe letërsinë bashkëkohore të rinj dhe fëmijë, ndanë përvojat e tyre dhe ofruan zgjidhje të mundshme mbi problemin që shfaq sot ky lloj i veçantë dhe i rëndësishëm i letërsisë.

Seminari me titull "Letërsia për fëmijë dhe të rinj: sfidat dhe mënyrat e zhvillimeve të saj" u drejtua nga Prof. Vladimir Vojnovica, i cili veç ligjeratës së mbajtur, moderoi edhe kumtesat e të ftuarve: Alan Riach - Profesor i Letërsisë skoceze në Universitetin e Glasgouit, Patricia Forde - shkrimtare irlandeze e serialeve për fëmijë në televizion dhe autore e shumë librave me drama për të rinj si dhe Drejtore e "Galëay Arts Festival", Vladimir Arseniaç I" - kritik i njohur letrar nga Serbia, Joerg Muehle - ilustrator gjerman të librave për fëmijë dhe shkrimtari, të Rita Ann Higgins, nga Irlanda - dramaturge dhe poete për fëmijë, të Andriana Kos-Lajtman, Branko Egec, Dragana Kršenković-Brković, Janja Vidmar, Miro Gavran, Svetlana Kalezić-Radonjaç si dhe të profesorëve dhe kritikëve të tjerë nga Slovenia, Austria, Kroacia etj.

Të gjithë pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e këtij lloji të letërsisë për socializimin e lexuesit të lexuesit të ri, nevojën për të krijuar ndjeshmëri më të gjera të këtij lexuesi dhe nevojën për të forcuar lidhjet me mjediset arsimore.

Në këtë veprimtari Silvana Leka dhe Arian Leka paraqitën dy kumtesa dhe referate, lidhur me përvojat e tyre si autorë, përkthyes e botues të letërsisë për fëmijë e të rinj. Kontributi i tyre u përqendrua kryesisht rreth çështjeve të

Seminari me titull "Letërsia për fëmijë dhe të rinj: sfidat dhe mënyrat e zhvillimeve të saj" u drejtua nga Prof. Vladimir Vojnovica, i cili veç ligjeratës së mbajtur, moderoi edhe kumtesat e të ftuarve



veçantive së kësaj letërsie në Shqipëri, prijëve të reja dhe rolit të autorit vendas përballë letërsisë së përkthyer dhe modeleve të përirimit të kësaj letërsie.

Kumtesa e Silvana Lekës me titull "Autori shqiptar, përballë letërsisë së përkthyer", trajtoi temat e nevojës së lexuesit të ri shqiptar për të krijuar marrëdhënie me personazhe nga kultura vendase, tabutë dhe klishetë që mbërrijnë prej një pjese të letërsisë të përkthyer dhe shpërfillja e kritikës dhe katedrave ndaj letërsisë për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj.

Në këtë kumtim u prekën edhe çështje të ndikimit të serialeve të librave, specifika e përkthyesit të librave për fëmijë, nevoja e këshillimit të titujve për këta lexues, përzgjedhja e kujdesshme e teksteve për lexuesin e ri, të cilat bëhen pjesë e leximeve shkollore, e kurrikulave dhe që arrijnë të futen edhe në sistemin e edukimit letrar në shkolla, si një mënyrë e krijimit të shprehive ndaj "lexuesit të përjetshëm", prej të cilit kërkohet të jetë jo një blerës i mirë, jo thjesht një lexues, por edhe një individ i pajisur me humanizëm dhe qytetari. një përmes këshillimit. Në tekst u trajtuan edhe çështje të zhanreve të reja që zgjerohen gamën e lexuesve të këtij lloji specifik të librit, siç janë novelat grafike etj.

Në kumtimin e Arian Lekës me temë "Globalizimi i shijëve letrare dhe stan-

dardizimi i imagjinatës: letërsitë vendase përballë përkthimeve ndërkombëtare", u shpjeguar teorisht dhe u shoqëruan me shembuj çështje të krijimit të stereotipeve kulturore përmes mosnjohjes së letërsive të brendshme dhe vërshimit të librave të përkthyer pa asnjë indikacion e vlerësim tjetër veç atij të "best seller".

Pasi paraqiti veçantitë e rastit shqiptar në letërsinë për fëmijë e të rinj, i cili, për shkak të implikimit me realizmin socialist dhe heroin pozitiv, hyri në shekullin e ri thuajse pa trashëgimi letrare, Arian Leka u ndal edhe në çështje të rolit të letërsisë për fëmijë dhe të rinj në shoqëritë multikulturore, multietnike, në shoqëritë në ku të drejtat e njeriut nëpërkëmben, shoqëritë me tranzicion të zgjatur dhe shoqëritë konflikuale.

Në një kapitull të veçantë ai trajtoi edhe opozicionin "letërsi realiste", bazuar në realitet dhe përditshmëri, përballë "letërsisë fantastike", të mbështetur në imagjinatë dhe fikcion. Arian Leka nënvizoi faktin e mbivlerësimit të letërsisë së përkthyer, sidomos të librave seriale, krijimin e mitit të letërsisë dhe ilustrimeve të importuar, përballë mohimit të letërsisë shqiptare për fëmijë dhe të rinj.

Pjesë e shtjellimeve bëhen edhe propozime në lidhje me tipologjinë e përkthyesit të librave për fëmijë, sidomos të përkthyesit të poezive për fëmijë, lloji specifik i gjuhës së përdorur në këto përkthime, vlera e leximeve nga letërsia klasike, përirimi i librit jo me fushata, por si një "rutinë e përditshmërisë së jetës", lidhja e drejtpërdrejtë mes autorit dhe lexuesit dhe si edhe pushteti i librit përballë mjeteve të reja të leximit.

Në stendën e hapur me këtë rast në Panairin Ndërkombëtar të Librit - Podgorica 2018, "Botimet POETEKA" u paraqit me 15 tituj të rinj, botuar në harkun kohor mes viteve 2017-2018. Titujt janë kryesisht nga letërsia ballkanike, autorë gjermanë dhe austriakë e veçanërisht 8 libra për fëmijë rinj, mes të cilëve libri me përallë "Mësimet e natës", nga Betim Muço, "Legjendat më bukura: Vëllimi 1 dhe 2" dhe vëllime me poezi për fëmijë "Sot lejoheft fluturimi", nga Arian Leka "Novela Botërore Vëllimi 1 dhe 2 (MIGUEL DE CERVANTES, CHARLES DICKENS, ANTON CHEKHOV, RUDYARD KIPPLING, SELMA LAGERLÖF, FRÉDÉRIC MISTRAL, MARK TWAËN, JACK LONDON, GUSTAVE FLAUBERT, LEO TOLSTOI, ALPHONSE DAUDET) libri dygjuhësh shqip - gjermanisht "Alle Da" me autor dhe ilustruar Anja Tuckermann dhe Tine Schulz, romani "Konradi - djali i kutisë së konservës", nga Christine Nöstlinger.

Arian Leka paraqiti gjithashtu në stendën e "Botimeve POETEKA" edhe librat e tij në gjuhën malazeze dhe serbe: "Jedanaest Aziënih esaja" dhe "Dolap", botuar në Mal të Zi dhe Serbi nga "Plima" dhe "Knjičevna radionica Rašiae".

P

PERSONALITET

Autori përcjell një nderim për shkrimtarin shqiptar, që ndërroi jetë dy vjet më parë. Teodor Laço, me korpusin e tij letrar, që përfshin mëse 50 tituj romanesh, vëllimesh me tregime, dramash, komedish e kujtimesh, zë vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, esseist, komentator, opinionist e politolog, ai padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj ku është përkthyer, si një nga kolosët e letrave shqipe. Por nëse, në këto gjini, Laço radhitet me elitën krijuese të kombit, ai si poet njihet pak. Jo se nuk ka shkruar poezi, por ato i ka ruajtur si "thesare" të laboratorit të tij krijues.

NGA HALIL RAMA

DEDIKIM PËR GAZETAT QË BOTOJNË LETËRSI

Vetëm dy javë para se të ikte përgjithmonë për në botën e përtejme (pikërisht në vigjilje të 80-vjetorit të ditëlindjes së tij) në "Gazeta Shqiptare botova opinionin "Vepra letrare e Teodor Laços" në tri dimensione", ndërsa për "Koha jonë" dhe "Nacional" përzgjedha tri cilke nga poezitë që ai i ruante prej dekadash në "thesin e tij poetik".

Vetëm disa ditë pas këtyre botimeve shkrimtari dhe politikani shumëdimensional, Laço, do t'u kushtonte këtyre tri organeve dedikimim e mëposhëm:

"Ishte një përkim i këndshëm që tri nga gazetaret, që ende lëvrojnë letërsinë dhe sidomos poezinë, gjejnë vend për këto "thërrime" të thesit tim poetik, i cili ndoshta do të mbetet nëpër dorëshkrime.

"Gazeta Shqiptare" me suplementin letrar të Ben Andonit, rreket të flasë me gjuhën e modernitetit poetik dhe kritik, e vetëdijshme se "Milosao" ka pasur dhe do të ketë gjithmonë.

"Gazeta "Koha jonë", e para gazetë opozitare, me kontribut të jashtëzakonshëm dhe konkurruese e denjë në tregun mediatic, duket sikur nxiton të kapë kohën e humbur me ajkën e letërsisë shqipe, por edhe me poetë të rinj, në suplementet dhe faqet e saj letrare.

"Nacional", sepse është e vetmja gazetë që i përkushtohet letërsisë dhe poezisë – sepse gara është e hapur në të gjitha trevat shqiptare, me një përkujdesje shembullore të botuesit të saj, mikut tim Mujë Bucpapaj, i cili më kujton fillimet e viteve '80-të, kur një tufë poetësh, zëra të rinj poetik derdhën frymëzim në tyre, veçanërisht nga tre burime: Tropoja – farefisi Bucpapaj, Hamit Aliaj e të tjerë; Preç Zogaj, Ndoc Gjetja, Agim Isaku nga Lezha; Petrit Ruka, Ilirijan Zhupa, Qazim Shemja nga Tepelena, "provincialë", por që më vonë u bënë autorë të njohur të letërsisë dhe gazetarisë.

Nostalgjia zgjon kujtime të bukura, por dhe të dhimbshme! Ç'të thuash për djaloshin me fat dredharak, Ilir Balliu, i çmuar fillimisht tepër lart nga brezi i tij dhe që më vonë u harrua në gërxhet e Dajtit!?

Dhe sërish "Nacional" që vazhdon të kërkojë mineral nga bjeshkët, atje ku është miniera e arit

I falënderoj dhe i uroj përzemërsisht!"
Urime dhe gazetave të tjera që kujtohen se ka edhe poezi!"

NDËR EMRAT MË TË SPIKATUR TË LETËRSISË SHQIPE

Në historinë e letërsisë shqipe, Teodor Laço është padyshim një ndër emrat më të spikatur. Ai ka hyrë në analet e kësaj historie si një shkrimtar shumëdimensional: si një nga romancierët dhe tregimtarët më të lexuar, si dramaturgu, komediani e skenaristi – ndër më të preferuarit e regjisorëve shqiptarë me emër, dhe së fundmi, edhe si një ndër poetët e esseistët më të mirë. Një vit më parë (vetëm një muaj) para se të largohet për në botën e përtejme do të ishte Gazeta Shqiptare, ajo që do të promovonte veprën e tij letrare në tri dimensione: si poet, dramaturg-komedian dhe si esseist. Ndërsa Ai vetë, do ta konsideronte suplementin "MILOSAO", të kësaj gazetë si tribunë të promovimit të letërsisë bashkohore që e ka kryer më së miri misionin e saj, duke mbushur në harkun kohor të gjashtë viteve të fundit atë vakuum të krijuar nga "shuarja" e

Teodor Laço: "Milosao" ka pasur dhe do të ketë gjithmonë



të dikurshmes "DRITA". Madje,

Laço, si një nga personalitetet më në zë të letrave shqipe, do të shprehej se - "Gazeta Shqiptare" me suplementin letrar të Ben Andonit, rreket të flasë me gjuhën e modernitetit poetik dhe kritik, e vetëdijshme se "Milosao" ka pasur dhe do të ketë gjithmonë.

"THËRRIME" NGA "THESI POETIK" I LAÇOS

Teodor Laço, me korpusin e tij letrar,



Shkrimtari shumëplanësh

Në historinë e letërsisë shqipe, Teodor Laço është padyshim një ndër emrat më të spikatur. Ai ka hyrë në analet e kësaj historie si një shkrimtar shumëdimensional: si një nga romancierët dhe tregimtarët më të lexuar, si dramaturgu, komediani e skenaristi – ndër më të preferuarit e regjisorëve shqiptarë me emër, dhe së fundmi, edhe si një ndër poetët e esseistët më të mirë.

që përfshin mëse 50 tituj romanesh, vëllimesh me tregime, dramash, komedish e kujtimesh, zë vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, esseist, komentator, opinionist e politolog, ai padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj ku është përkthyer, si një nga kolosët e letrave shqipe.

Por nëse, në këto gjini, Laço radhitet me elitën krijuese të kombit, ai si poet njihet pak. Jo se nuk ka shkruar poezi, por ato i ka ruajtur si "thesare" të laboratorit të tij krijues.

Por pikërisht, në pragun e 80-vjetorit të lindjes së tij, (29 shtator 2016) nga labirintet e këtij laboratorit arritëm të zbhirojmë talentin e tij të rrallë edhe në poezi. Poezi të shkruara në harkun kohor të pesë dekadave, përmbajtja e të cilave rrok hapësira të gjera dhe përfshin gjithçka që ka të bëjë me jetën tonë.

Ku u lind dhe u rrit

Ai u lind dhe u rrit në Dardhë të Korçës. Në atë fshat që sipas tij, nuk ka të dytë; "në fshatin tim malor, - do shkruaj në një tregim, - netëve të verës, qielli është një magji që mund të mrekullojë edhe shpirtrat e thatë. Gjithësisht e hap gjirin në një tejdukshmeri të ndritshme dhe atëherë, etja të duket më pranë së kurrë me hënën e madhe që lëviz si mbi një lundër në detin e errët të kreshtës mbi korijen e Shën Pjetrit, me yjet e mëdhenj që vezullojnë dritë shkëlqyese, me yjet e vegjël që regëtojnë në të venitur, me yjet që bien e digjen, duke ndjellë trishtim për jetët që shuhen".

Në fushën e letërsisë, veprat e tij do të përbënin një zgjedhje të preferuar për lexuesit që më tregimin "Malaji" e deri në romanin e fundit "Gropas 67", botuar në 2014.

Disa nga librat e Teodor Laços:

- Era e tokës (1965)
- Shtëpia në rrugicë (1968)
- Një natë shiu - 1969
- Një nuse për Stasin (1970)
- Tokë e ashpër (1987)
- Korbat mbi mermer (1981)
- Të gjithë lumenjtë rrjedhin (1987)
- Pushimet e kolonelit (1990)
- Shi në plazh
- Vrasja e buzëqeshjes
- Një dritare në Kremlin
- Mjegull (2009)
- Gropas 67 (2014)

Mjafton qoftë edhe një lexim i vëmendshëm për t'u mrekulluar me poezinë e Laços që është poezi përgëndrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta, përsa i përket formës dhe kompozicionit, si p.sh tek vjersha e titulluar: "MOTIV LAGUSHIAN" (kushtuar bashkëshortes, MIRJANËS): "Më trokite prej së largu/ me një degëz dashurie/ miturisht e çmendurisht/ më vjen natën si një hije./ Grua je a lozonjare/ kërkon prehe apo halle/ qofsh çapëne apo manare/ ti më vdiqe, ti më ngjalle..."

Apo dhe tek poezia: "KAFENETË E TIRANËS": "Kioska, kafene/ kryqëzime kryefjalësh/ kryeqendra kryeqyteti/ Pagat në pus/ Çmimet në qiell/ raca e çuditshme/ shtyn ditën./ vret kohën kafeneve.../ Edhe një kafe e pimë/ një "koka", një çaj/ Bajmë fjalë/ qeveria të rrëzohet/ duhet të bjerë/ qeveri e mjerë! /...nga kioskat tryeza: / qeverisim më mire/ pak kryeministër/ pak president/ lumi i nxori në breg/ ne lundrojmë në pritje me turmën!..."

Gjen në poezitë e tij tituj shumë intrigues që të bëjnë për vete që në krye të herës. Mendimin e thellë filozofik të këtij gjeniu krijues e dallon qoftë dhe në vargjet: "O, si hesht, si nuk pëlqet zemërimi/ I lidhur në prangat e durimit!..."

Në tërësinë e tij, ky cikël (si edhe qindra vjershat e pabotuara të Laços), shpalos profilin poetik të një poeti me ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi midis tradicionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjeteshe dhe teknikash poetike, me struktura vargshje e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik. Këto risi të poezisë së tij mund t'i dallojmë më së miri në vargjet e vjershës me titull:

"Pendim": "Kur zë e ngriset dita e përhimë/ dhe nisin të përgjumen plot vegime/ ca mllfe, ca inate, ca metime;/ Një tog me hi, një mal zhgënjime/ Filloj i flas e vras vetveten time.../ Pse rashë pre e kotësisë/ e kohëhumbjes, rastësisë/ e rrethit mëkatër të prapësisë/ ku plot shtriganë të babëzisë/ Shtrëngojnë lakun e fatkeqësisë?/ Kur zë e ngriset dita e përhimë/ filloji i flas e vras vetveten time..."

Apo dhe të poezia: "FUNDSHEKULLI SHQIPTAR": "Tymtarët e krimt/ vjellin shtëllunga.../ qielli i mbyllur, i blazët/ hedh shira blazë./ Tymtarët e kartës/ brerjnë breshër rrenash/ tymtarët e gojës/ cipën e ndrangur hedhin.../ Fundshekulli shqiptar/ ceremonial pambarim/ i kortezhit të shpresave..."

Ky cikël, të cilin personaliteti i shquar i letrave shqipe ma besoi mua për ta botuar në ndonjë të përditshme letrare, disa muaj para se ai të mbushte 80 vjeç (që u botua në "NACIONAL"), do të përbënte embrionin e vëllimit poetik "Hapjani dritaren pulëbardhës", të cilin familja e tij e botoi tetë muaj pas ndarjes nga jeta të Teodor Laços. Siç është shprehur poeti Bardhyl Londo, vetë titulli i poezisë "Hapjani dritaren pulëbardhës" që shërbeu si titull i librit është një metaforë që të gozdon menjëherë. "Një himn për dashurinë, mirësinë, humanizmin, shpirtin lirik. Pulëbardha është pastërtia njerëzore është humanizmi, dashuria, dhembshuria, miqësia, lirizmi, shpirt i pavdekshëm dhe i panjollor nga djallëzitë dhe paudhësitë e përtshme njerëzore. Kësaj pulëbardhe simbol duhet t'ia mbajmë gjithmonë derën hapur, të mos ia mbyllim kurrë edhe kur shfrynjë erërat e ftohta dhe të tërbuara të dimrit të egër. Pulëbardha është vet shpirti i Teodor Laços, që do të na trokasë gjithmonë në dritare", shprehet B.Londo. Dhe në të vërtetë: "Hapjani dritaren pulëbardhës/ Që stërkala shpresash po iu shkund./ Që çan me afsh këtë qiell mardhës dhe zgjon e ngre e shkund e mund..." është një imazh i rrallë, me një lirizëm dhe humanizëm që shok ka vetëm veten. Vargu i fundit vjen si një kreshendo shpërthyes që godet, ngre stërkala, shkumëzon: është një varg, i cili nga mënyra si është ndër-

të me kolosin e letrave shqipe T.Laço (1996-2016), në memorien time janë skalitur kujtime për kohë të shkuara dhe nostalgji rinie, punë dhe përpjekje mes njerëzve të dashur, miqve dhe shokëve, prej të cilëve (siç shprehet ai me modesti), një pjesë të mbeten bashkudhëtarë dhe plot të tjerë, kanë kohë që kanë shkruar nga kjo botë duke lënë pas kujtimet.

Por për një shkrimtar të mirënjohur si Ai, jeta dhe bota, fare mirë mund të vijnë edhe përmes letërsisë së shkruar dhe botuar ndër vite, si një dritare e së shkuarës dhe të tashmes.

Ai u lind dhe u rrit në Dardhë të Korçës. Në atë fshat që sipas tij, nuk ka të dytë; "në fshatin tim malor, do shkruaj në një tregim, netëve të verës, qielli është një magji që mund të mrekullojë edhe shpirtat e thatë. Gjithësia e hap gjirin në një tejdukshmëri të ndritshme dhe atëherë, etja të duket më pranë së kurrë me hënën e madhe që lëviz si mbi një lundër në detin e errët të kështjës mbi korijen e Shën Pjetrit, me vjet e mredhës që vezullojnë dritë shkëlqyese, me vjet e vegël që regëtojnë në të venitur, me vjet që bien e digjen, duke ndjellë trishtim për jetët që shuhen".

Në fushën e letërsisë, veprat e tij do të përbënin një zgjedhje të preferuar për lexuesit që më tregimin "Malaji" e deri në romanin e fundit "Gropas 67", botuar në 2014.

Në gjithë krijimtarinë e tij, Teodor Laço, krijoi karaktere të çdo kohe, e disa prej tyre u mishëruan edhe në prodhime të Kinostudios Shqipëria e Re, si "Përballimi" "Shi në plazh" etj.

VEPRA LETRARE E LAÇOS KA VEND PËR ANALIZË TË THELLA

Në letërsinë e Laços lëvrijnë pafundësisht vajza dhe gra, studente dhe geologe, agrome dhe fshatare, mjekë dhe artiste. Të dashuruara dhe fatqeke. Me dramë të jashtëzakonshme si partizanica e plagosur që përdhunohet prej Demos, deri edhe e vdekur, apo me fund të lumtur si Ana, tek tregimi me një antagonizëm dashuror të jashtëzakonshëm kur njeriu provon ta zgjojë atë tek vetvetja e harruar dhe e fjetur, apo "Ngrohësia e të tjerëve".

Në veprat poetike e proza-ike, dramaturgike apo studimore të Laços ndërthuret një lëndë letrare shumëgjyreshe me dramaticitet dritërues, plot shpirtëzime estetike që bujojnë nga brendia e përmbajtjes. Siç është shprehur shkrimtari Andon Andoni "vepra letrare e këtij shkrimtari ka vend për analiza të thella dhe që, duke iu qasur asaj në tri dimensione, të kohës së shuar".

krimeve, gjedheve dhe llojeve të gjinive letrare që lëvroi, si dhe tematikës së gjerë që trajtoi në to, do të përmbushej një bosllëk i madh që kritika letrare në veçanti, por dhe studiuesit e fushës së letërsisë në përgjithësi, u kanë borxh letrave shqipe të më se një treçerek shekulli". Madje si është shprehur prof. Zymer Mehani "Në krijimtarinë e shkrimtarit Teodor Laço kritika ka veçuar vërtetësinë dhe prirjen për zbirime psikologjike të botës së njeriut të mirë e altruist, vizatimin e karaktereve me penelata të holla, lirizmin që nuk mungon as kur subjekti shtjellohet në situata konfliktesh, përkrahimin poetik të natyrës. Metafora e tij më shprehëse duket se kërkohet të bardhësia e borës dhe trishtimi i mjegullës. Krijimtaria letrare e shkrimtarit Teodor Laço Teodor Laço, ndër emrat më të njohur në letërsinë shqiptare, përfaqëson në të njëjtën kohë një nga ato dukuri të rralla kur shkrimtari lëvron me sukses në disa fusha të letrave.

Teodor Laço lindi më 29 shtator të vitit 1936 në fshatin Dardhë të Korçës, vdiq më 15 tetor 2016.

Ai ka studiuar Agronomi në Universitetin e Tiranës. Ka filluar të botojë që prej viteve '60. Për kontributin e tij intelektual, krijues e veprimtar Teodor Laço mban "Udhërin Naim Frashëri të Klazit të Parë", "Çmimin e Republikës" si dhe emblemën "Qytetar Nderi" i Qarkut të Korçës.

P

PROZA

VEGIMI

Shpesh nënvlerësojmë pushtetin e një kontakti, të një buzëqeshjeje, të një fjale të mirë, të një veshi të kujdesshëm, të një përgëzimi të singertë, apo të vëmendjes më të vogël; të gjitha kanë pushtetin e ndryshimit të jetës.

Leo Buscaglia

Kapakët e syve, si të ishin mbar të të dy copa tullash, më rën donin duke mos më lejuar orientimin. Me sforcim nën qer pikë, arrita të vjedh vetëm bardhësinë e vendit ku ndodhesha. Ndodha ishte edhe perde, që nuk më linte të shihja më larg. Nuk kishte asgjë të përbashkët me parajsën, por as me ferrin jo. Më gëzonte fakti që nuk ndieja dhimbje.

"Më qoftë dhe i lehtë!" Por këtu s'kishte as dhë... Cili është kthyer nga e përtejnjata të na shpjegonte dekorin... Nga Dantja më vinte ndër mend vetëm "Purgatori", por vendi ku ndodhesha s'kishte asnjë rresht që t'i përshatej.

Nga kangelat qerpikë munda të këqyrja vetëm bardhësi. Po i kërkjoja ndihmë kujtesës për të kuptuar ç'po më ndodhte, pse vegjetoja në këtë shtrat pa asnjë arsye. Thitha fort oksigjenin e përzier me erëra barnash, që më ndihmoi t'i bija në të se isha në një mjedis spitalor. Duart dhe këmbët sforcoheshin të gjenin lirin, por ishte e lodhshme. Gjithësi e falesha trupit që reagon, edhe pse me vështirësi. Ngrita lehtë dorën e majtë që, fatkeqësisht, s' mund të shkonte larg, penguar nga dicka, të cilën ende nuk e perceptoja dot. Çdo sekondë më dukej një betejë, për të kuptuar ku ndodhesha dhe pse isha aty. Dora e djathtë përparoi më guximshëm drejt pikëmarakut tim. Shtypa me aq forcë, sa për të verifikuar nëse "burrëria" ime ishte funksionale. Domethënë e ndjeu dhimbjen, reagoi nga prekja, më pas varej nga të tjera kushte. Mora frymë i lehtësuar.

Amen! Gjallë dhe burrë. Kaq më duhej për momentin, ndaj pullita sytë duke falënderuar Zotin, edhe pse në kishë hyja vetëm kur kisha vapë. Zoti më ndjefte! Veshëve më oshinte një simfonijë gjinkallash dhe veten e shihja në makinë. Mora frymë i lehtësuar dhe kërkjoja në ekranin pa shumë ngjyrë para syve të mbyllur, të kuptoja kilometrat e fundit që më kishin sjellë në këtë ambient. Si në vegim më erdh në mendje ardhja në këtë qytet, i cili kishte më shumë pulëbardha se njerëz.

Po me çfarë misioni...? Udhëtoja për diku. Diell, gjinkalla, Morikone, si në filmat Eastern, në rrugë pa rrugë e pa tabela. Shkoja kuturu, si i thonë plakat e vjetro. Dilnin njerëzit si katra dhe kur i pyesje për drejtimin apo largësinë, ishin të prerë njësoj: "Ja, ec përpara, hiç mos u lodh majtas-djathtas. Ja, as dy-tre, shumë-shumë pesë kilometra, nuk je larg".

Qeshja me vete për zerot e harruara të "kilometrave" të tyre. I gëzohesha peizazhit qetësues, ndjekur nga kori i gjinkallave, që duhej të më kishin marrë për dirigjent, tek nuk më ndaheshin.

Më bëhëj një muzikë e njohur; që duhej se më rëmbente e më çonte diku, por nuk e kuptoja ku. Fushë, pastaj një tjetër fushë, një pyll dhe pastaj përsëri një pyll. M'u krijua beshshtypja se rruga më çonte majtas dhe mora kthesën majtas. Isha fu-

Një tregim i këndshëm, që mund të ishte kurruar pak më thjesht, pa nevojën e ndërhyrjeve. Gjithsesi struktura e tregimit e tregon shumë të pjekur autoren...

tur në një udhë qorre, por s'kisha zgjidhje. Duhej të gjeja një hapësirë të ktheja makinën.

Një moment m'u bë se pashë një hije, që u zhduk sërisht. Shëmbëllimi ishte si trupi i një gruaje me një gërshet, por mund të ishte vegim. Tani, jo se do ishte keq të ndeshesha me ndonjë shtojzovale në këtë vend aventurier, por ky do të ishte luks.

Nga larg dallova fundin e pyllit, jo më shumë se njëzet metra. Apo thuaj edhe metrave të mia ua harrova zerot prapa. Kësaj here vërtet syri kapi një trup me trajta femërore, i cili fluturoi në krahun tjetër të shtegut, në fund të tangallës.

"Ç'kishte kjo zanë në mes të pyllit, kur pas pak do të bjerë mbremja...?"


Kori i gjinkallave sa vinte e rrallohej. Tashmë orkestrimin e kishte marrë kënga e bulkthit, duke më hedhur në skutat e fëmijërisë sime të largët. Nga dritarja e hapur e makinës vërshoi një vlagë xehëstie, përzier me fëshfërimin e dobët të gjetheve, që më shumë i shihja se i ndieja.

Kjo vashë në pyll po më çorientonte. A thua ishte Amazonë e pyjeve? Motive popullore më vinin në mendje nga këngët, me të cilat përkundesa mbremëjeve nga zëri i tim etit, derisa u bëra burrë, siç thuhej në atë kohë që përkonte me mbarimin e shërbimit ushtarak.

Kur më shkoje rrugës tutje, gërshetat hedhur mbi supe, buzë lule më këputë, bishti i jelekuat me rrupe.

Nuk kisha vënë gram alkooli në buzë, kisha lënë mënjatë dhe kafënë me konjak, hapja e ditës në këtë vend. Beharit kishte shumë aksidente rrugore, për shkak të shkeljeve të rregullores, ndaj mundohesha të isha sa më aq në timon. Truri dhe trupi ishin esell, veç lodhjes dhe vapës. Po i afrohesha fundit të shtegut dhe u gjenda përballë një gardhi me shkurre. Ndaloja makinën dhe dola. Çdo më gjejë, femër është? Unë i humbur jam këtu, vetëm në fitofsha. Mendime të mbrapshta.

U drejtova për nga gardhi, ku syri më kapi një parullë të shkruar me rëshirë: "Ndalohej hyrja në pyll! Rrezik!" Në rregull, por nga vjen rreziku. Ngadalësova hapat; shtypa degët e shkurreve; kalova një metër, dy... pesë, dhe shtanga. Hapat u bënë më të vegjël dhe më dyshues. Ajo që kisha para syve më bëri të hezitoi për një moment. Përpara shtrihje një shesh me një, dy, tri, katër... shtatë pemë të gdhendura. Sytë shkuan tek trugu i parë. Pashë buzët e holla të një femre, skalitur në detaje, deri edhe plasjet, punuar po aq mesjetërisht. Vështirësi rreshqiti drejt trungut të dytë, gdhendur një sy profil, që pasojë nga një lot, i cili kullonte si në një trëke drejtuar nga trugu i tretë, ku ishin gdhendur dy duar të bashkuara, thua gati për një tango. U rrotullova me kujdes nga pema e katër. Dalohej një



KUJTIME PËR KOHË TË SHKUARA DHE NOSTALGJI RINIE

Todi siç e thërrisnin miqtë, me një diplomë në bujqësi, për të cilën punoi si agronom për një periudhë të shkurtër në vendlindje, Korçë, do t'i përkushtohet letrave në fillim viteve 60-të.

Është autor i shumë romaneve, novelave, përmbledhjeve me tregime, dramave, komedive, skenarëve të filmave artistikë dhe dokumentarë. Disa prej librave të tij janë vlerësuar me çmimet më të larta që jepen në Shqipëri, ndërsa pjesë të rëndësishme të veprës së tij janë përkthyer e botuar edhe në gjuhë të huaja. Pas viteve '90 është angazhuar edhe në jetën politike të vendit, për dymbëdhjetë vjet ka qenë deputet në parlamentin shqiptar, ministër i Kulturës në vitet '94-'97 dhe ka përfaqësuar shtetin shqiptar si ambasador në Federatën Ruse.

Gjatë dy dekadave bashkëpunimi të ngush-

→ Vizion nga faqja 17

vesh, i cili nga forma dukej si i një maskulli. Trungu i pestë, me dy zemra të bashkuara e të harkuara, më dha një dritidhe të lehtë në trup. Sa shumë dashuri paska në këtë copëz vend...

Gjendesha në një ekspozitë në natyrë. Përse nuk kishte asnjë tabelë ku të lejoneshin vizitorët, por "Rrezik kalimi!"? Qarkohesha rreth vetes si të më ishte përcaktuar këndi i kundërimit. Trungu i gjastë ishte një libër me dy faqe të hapura. U mata të afrohesha për të parë se çfarë ishte shkruar, por një fëshfërimë e shkaktuar pas meje më bëri të hezitoj. Dikush po më ndiqte në veprimet e mia. Ndoshta ajo...

Rrotullimi 360 gradë më gjeti sërish në pikën e referimit, pa dalluar asnjë hije. Shikimi u ngulit te trungjet e bashkuara. Bëra t'u afrohem dhe sërish u largova, duke u përpjekur të gjeja pozicionin e duhur. Ishte një kabinë e vogël. Në portën e saj dy statuja, ku vajza strukej në kraharonin e djalit. Mbi kabinë ishte gdhendur një copëz druri në formë rrufeje. Në momentin që u zhvendosa për të gjetur pozicionin e duhur, rrezja e diellit këputej pikërisht mbi rrufe. E çuditshme! Të jepte përshtypjen sikur ajo rrëkëllehej pikërisht mbi dy trupat e bashkuar. Dashuri dhe historia... Pa dyshim, s'ka dashuri pa histori, por cila ishte kjo këtu... Gdhendje kaq të bukura të mos ishin të soditura prej të gjithëve...

Lu afrova secilës nga afër, duke ndier dëshirën e prejkes, më saktë të përkëdheljes. Një ndjesi e ëmbël, e cila të rrëmbente dhe të bënte të kërkoje njerëzoren në këto trunqe pa jetë, por me shumë emociion. Kishte diçka familjare në këto gdhendje. Më erdhi ndër mend pagurja që im atë kishte gdhendur para se të largohesha "në dheun e huaj" dhe kujtimi i fundit prej tij.

Vepër e mrekullueshme... Cila dorë duhej t'i kishte bërë? Cili ishte mesazhi? Seria e pyetjeve u ndërpre nga një krisim hapash. Tani isha i sigurt, që dikush ndohej pas meje. Këmbët e gozdhura u kishin dhënë liri vetëm syve. Përballë ishte hija njerëzore me trajtat e vërteta të një vajze rreth të tridhjetave, me flokët si korb i zi, që i pugeshin ngjyrës së syve, me vështrim më tepër kureshtar-inatçor se të trembur. Flokët e thurura në një gërshet "Shote" i binin mbi kraharonin, që i gufante lehtë. Veshur kishte një fustan deri në fund të këmbëve, gri në jeshile, nuk arrija të bëja dallimin, edhe pse qëndronte pak metra larg meje.

Ndihesha si në përrallë. Ishim vetëm në të dy apo përrëth përgjoheshim nga Orët e Mujit, shtojzovallet? Zgjata dorën për të parë edhe reagimin e saj, por nuk u luhat as dhe një milimetër. Kurrgjë nuk ishte e vërtetë, ndryshe do të kishte kundërvepruar. Buzët e saj pëshpëritën:

- Askush nuk duhet të vijë këtu!

- Përse?

Pyetja ime ishte po aq e shpejtë, sa prisja dhe përgjigjen. Po dialogoja me një njeri apo me një qenie me trajta njerëzore? Vështrimet tona u ndeshën në një duel aspak kërcënues.

- Vetëm unë kam të drejtë. Unë jam shpirti i tij. Nuk arrita ta mbroja në jetë...

Duke qenë se ende nuk bëja dot dallimin midis reales dhe urreales, përparova drejt statujës libër me hapa të vegjël. Nuk e di pse, por doja të gjeja një tjetër informacion. Hodha sytë në mbishkrimin e gdhendur: "Shpesh nënvlerësojmë pushtetin e një kontakti, të një buzëqeshjeje, të një fjale të mirë, të një veshi të kujdesshëm, të një përgëzimi të sinqertë, apo të vëmendjes më të vogël; të gjitha kanë pushtetin e ndryshimit të jetës".

Ktheva kokën në kujdes, duke prit shpjegimin e një fantazme për rrethana.

- Nuk duhej të dilte atë pasdite. Ishte ditëlindja jonë dhe duhej ta festonim së bashku. Sa e vështirë është të kuptosh ikjet e njerëzve, të cilët ti i mendon pjesë të pandashme të jetës tënde. Kujton se ke të drejtën dhe pushtetin deri në fund mbi ta... Kupton se ti nuk i përket askujt sa i përket vetes në radhë të parë dhe dashuria dhe liria fillon po aty...

U mbloodh kruspull rreth vetes, me vështrimin e përhumbur, ndoshta në atë natë. Ngriti kokën nga qielli, pastaj ju avit



VEGIMI

kabinës së çiftit duke u shtrënguar pas "rrufesë".

- Pasdite që nuk do ta harroj kurrë, me një nxehtësi përvëluese, e më pas një shi me vetëtimë, bubullima, rrufe të njëpasnjëshme. Makth i tmerrshëm më zinte frymën. Ka net, që ti e kupton se do të mbeten në jetën tënde, dhe unë e ndieja, por nuk kisha forcë ta ndaloja.

Vështrimi i bridhte nga njëra statujë në tjetrën, vetëm tek unë jo, sikur nuk ekzistoj.

- Trupat i zbuloi të nesërmen një rojtar plak, që kishte parë rënien e zjarrit në mbremje. Mund edhe të mos i kishim gjetur kurrë. Thonë se ajo ishte nata më e tmerrshme që ka njohur ky qytet në jetën e tij. Liqeni pranë doli nga shtrati dhe përmbyti si i tërbuar gjithë zonat përreth.

Timbri vajtes dhe me korda

drithëruese më bëri ta shihja me keqardhje, pa pasur forcë ta qetësoja. U ul në gjuhë përballë kabinës si virgjëreshat në kishë, me lutjet e tyre të së dielës. Gishtat e hollë e thurnin e shturnin mekanikisht gërshtin e zi.

I dashuri e kishte tradhurar me dikë tjetër, gjithçka ndodh në jetë. Ditën e ditëlindjes kishte ardhur në pyll për shëtitje dhe rrufeja i kishte vrrarë të dy Natyrisht ishte një tragjedi humbja e dy të rinjve, por përse shpirti i saj vajtonte ende, përse ajo duhej të ndihej fajtorë?

- Askush nuk duhet të vijë këtu, nuk ka të drejtë. Do të jepja jetën të ishte gjallë, por ai...

U ula në gjuhë përballë saj dhe pashë sytë e mbufatur nga lotët. M'u duk aq e brishtë, aq e pambrujtur, sa do të doja ta merrja në kraharon; por i druhesha reagimit të saj. Nuk ishte shtojzovalle si nëpër libra, por ishte portret i plagosur dhembshurie dhe besnikërie. Brenga i kishte zënë vend në shpirt. Keqardhja ime s'mund t'i ringjallte ata të dy dhe t'i kthehte dashurinë, që kishte humbur. Pylli po më dukej si një skenë: statujat, fëshfërima e gjetheve nga era, ajo e vetme me brengën e saj.

- Nuk po e dënoni veten rëndë? Jeta nuk mbaron këtu! As dashuria nuk shteron kështu, derisa shpirti është gjallë. Ju duhet të gjeni forcën ta doni jetën. E shkuara nuk duhet të bëhet varreza e së ardhmes suaj.

Nuk di nga më doli kjo filozofi, por doja patjetër që të më shihje në sy, të kapërdinte lotët, të buzëqeshite dhe t'i premtonte vetes se do të përpiqej të jetonte jetën e saj.

- Njerëzit thoshin se isha e cmendur, isha një fantazmë që...

Zëri i këputur si shpirti i saj më bëri

t'i afrohesha më pranë. Nuk i frikësohej aspak përbalësisë me mua. I zgjata dorën. Vështrimi i saj m'u duk më ingrohtë, sikur përshkoi gjithë qenien time dhe më dha guxim, ose ashtu m'u duk mua.

- Nuk di se çfarë thonë njerëzit, nuk di se si janë fantazmat apo shtojzovallet, por ju jeni e gjallë dhe nuk duhet t'ia mohoni vetes këtë të drejtë, ndoshta dhe për hir të dashurisë. Njerëzit nuk e ndiejnë dhimbjen sa ju. Ata ndoshta ju kanë harruar. U jepni të drejtën që ata t'ju vrasin? Njeriu ka gjithmonë një dashuri e cila e rrit, por jo që e vret. Nëse është ajo që detyra, do të thotë se nuk është ajo që dëshiron... Më vjen vërtet keq për çfarë ju ka ndodhur, por do të ndieja më shumë keqardhje nëse do t'ju të ndodhë diçka. Ju keni të drejtën jo vetëm të jetoni, por dhe të shijoni jetën tuaj...

Vështrimi i saj m'u duk si ai tuneli i errët, ku ti këmbëngul të gesh dritëzën e zbehtë, që të tërheq për të të çliruar nga makthi. Çuditërisht dukej sikur e kërkoja unë dritën e shpëtimit, jo ajo. I preka paksa fundin e gërshetit, pa kërkuar të përfitoja nga afërsia, por një ndjenjë e brendshme njerëzore, më shtynë t'i shtrëngoja duart, si për të bërë atë këmbim energjish, që dy trupa kanë nevojë t'ia transmetojnë dikujt që duan t'i gjenden pranë. Ndjeva një çlirim, një si goditje të brendshme, si aparaturat e elektroshtokut, që u bëjnë njerëzve për t'risjellë në jetë, shoqëruar nga një nxehtësi, që më mbyste kraharonin. Statujat po rrotulloheshin rreth meje dhe më pas gjithçka m'u bë krejt e bardhë.

Hapa sytë dhe gjeja e parë që ndesha ishte buzëqeshja e një fytyre femërore me flokë të zinj, lidhur gërshet, që i binin në krahun e majtë. Nga afërsia, dora u përkëdhel prej tij. Këtë shkëlqim e kisha ndeshur më parë!

- Ju... Ku jam?...

Buzëqeshja e shoqëruar me një frymëmarrje të gjatë nuk më ndihmoi shumë në ato momente.

- Jeni në spitalin e qytetit. Ju sollën disa udhëtarë, që ju gjetën të alivanosur pranë makinës suaj. Tani nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Pësuaat një aksident, duke u përplasur me një nga pemët më të vjetra të qytetit. Muajt e verës ndodhin këto aksidente nga ju të huajt...

Edhe pse fjalët e saj ishin kritikuese, gjë që nuk i besoja, se isha gjithmonë i kujdesshëm në makinë, ngazëllimi dhe buzëqeshja e sinqertë më ngrohte.

- Po ju? Si jeni këtu... Statujat... Ju nuk po qani më...

I preka gërshetin, ishte i vërtetë. Kërkoja elemente, që të më siguronin se isha gjallë. Po unë edhe pak më parë isha i

gjallë...

- Jam mjeke, quhem Dona... Ju kam ndjekur këto dyzet e tetë orë, sepse ju humbët vetëdijen. Do të vij t'ju shoh pak më vonë, por tani qetësohuni. Infermieret do të kujdesen për ju, për çdo shqetësim, por ju siguroj se gjithçka kaloi. Jeni në dhomën e reanimacionit. Tani këni nevojë të flini, të pushoni.

Buzëqeshja dhe vështrimi i saj, kërkonin heshtjen dhe mosforcimin tim.

- Po statujat...

Ajo ishte pranë meje! Mbylla sytë, duhej të flija, isha më së gjallë.

Shtojzovalja u largua me hapa të lehtë, por do të kthehej. Si nëpër gjumë ndjeva derën që u hap dhe dy bluzat e bardha që trëshqitën nëpër dhomë.

- E pe doktorëshin, që sapo doli? - u dëgjua zëri i hollë dhe i ulët i njëres prej bluzave të bardha.

- Po, e pashë. Sa flokë të bukur që ka shtriga! - psherëtiu zëri i dytë.

- Eh, e shkreta thuaj! Ka një histori të dhimbshme. Ditën e 25-vjetorit të ditëlindjes i vdiq vëllai binjak. I gjori, kishte shkuar në pyll me të dashurën dhe atje qoftë, i zuri rrufeja të dy ditë për diell, si i thonë. Ka vuajtur korbë zeza. Për ca kohë thoshin se i iku truri. Ka qenë yll, peri është pak t'i thuash. E ëmbël është dhe tani shtojzovalja. Një vit rresht zhdukeje me ditë e javë të tëra. Çfarë nuk thoshin njerëzit, por asgjë nuk kishin parë me sy. Nuk i dha njeri dorën ta ndihmonte korbën, se edhe prindërit i kishin lënë jetimë.

Zëri i hollë mori pak frymë. Më ndërruan çarçafët me një shpejtësi, që nuk e kuptova sa zgjati: një minutë apo një orë. Prisja me padurim vazhdimin e bisedës për shtojzovalen.

Shkollën për doktorëshë e ka mbaruar me të gjitha dhjeta. Kanë qenë familje me biografi të keqe, që nuk shihej mirë nga shteti atë kohë, por se për çfarë arsyeje nuk e di. Të ngjethet mishi kur kujton jetën e saj, që nuk ia uroj as hamit. Në internim nuk i çuan, po jetën ua bënë të vështirë. Erdhi demokracia, të pakën i dhanë të drejtën të vazhdonte shkollën. Iu dëshën rreth të vjetra ta pranionin në spital, se kishin frikë mos cmendje prapë dhe, në cmenduri e sipër, kusheji ç'bente.

Infermierja që fliste m'u afrua të më shihte për temperaturë, thjesht me dorë. Mirë që nuk e bën me gjuhë, si gjyshja ime dikur... Pse m'u kujtua tani... Sa nuk e tradhetoja veten, por u përmbajta. Prisja t'i dëgjoja, kur flisnin për të.

- Po më të cmendur se janë bërë njerëzit sot, nuk besoj se do t'i bënte, vetëm t'i sillte në vete. Është tridhjetë vjeçe, sa i festoi para dy muajsh, beqare shtojzovalja, që pastaj dy fat të bardhë do Zoti!

Të dy zërat vinin vërdallë krevatit. - Një ndër mjeket më të mira që kemi. Me zemrën e artë dhe duart flori. Nuk merr kurrë një kokërr lekë, shpesh edhe nga xhepi paguan për ilaçet e të varfërve. Thonë se dhe drurin e gdhend si i ati, që ishte artist, ndaj dhe nuk e degdisën atëherë. Me të dëgjuar e kam. Thonë se ka bërë ca gdhendje të bukura, po asnjë nuk e di si dhe ku janë.

Po dëgjoja dhe nuk arrija të përgjigjesha. Do të më besonte kush që i kisha parë? Me sytë mbyllur prisja vazhdimin e thashethemeve të infermiereve, që e njohin tjetrin më thellë se vetja.

Ky i shkreti ka dy ditë i vilanosur. E shpëtoi doktorëshja, i ndenji te koka. Po ja, i është larë çehria, se na trembim. Është dhe jabanxhi i shkreti, djalë i ri, tridhjetë e pesë vjeç, refugjat. Ka ardhur të bëjë varret e prindërve, pas njëzet vitesh kurbet. E njohu një nga ata që e sollën. Jetëgjati nuk bëhet jetëshkurtër. Jetim dhe ky i shkreti, njeri pa njeri. Eh, hajde se hallet e të gjallëve nuk kanë të sosur, hë grua? Zoti nuk e shpëtoi kot.

U larguan duke tërhequr derën, kurse unë "jetëgjati" po merrja frymë i lehtësuar. Nuk doja t'i hapja sytë. Kisha nevojë për gjumë. Ajo ishte pranë meje dhe isha i sigurt që do të kujdesej për gjithçka, zana e statujave, e cila kishte marrë trupin, ndoshta dhe fatin tim në dorë.

Shtojzovalja nuk ishte më një vegim, nuk ishte më një rrefënjë, dhe unë isha i gjallë.

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Viti 1991. Kroatët luftojnë me mjetet e fundit kundër maki nerisë së stërmdhe ushtarake serbe. Anipse besimi, forca dhe dashuria për atdheun nuk mjaftojnë. Atëherë, dikujt i shkon në mend një gjetje e jashtëzakonshme. Në sheshin kryesor të qytetit thirren për çdo natë të luten, të gjithë qytetarët. Dhe, kështu ndodh. Në një orë të caktuar të mbrëmjes, e cila koincidon me momentin e agresionit të ish-popullit vëlla, kroatët të gjithë luten. Po, po luten. Pleq, të rinj, gra dhe burra. Më pak të rinj. Këta të fundit janë thirrur nën armë. Me ungjij në dorë, çdokush që e ndjente veten kroat lutej. Për çfarë? Për atdheun! Për tokën! Për shtëpinë! Fëmijët, që kanë shkuar në luftë! Bukën! Gjithçka... Si i huaj, mes turmës që shndrit me qirinj, më mbet ndërmend një nga pak momentet e sinqerta sesi një popull i bën mirëseardhjen agut të së ardhmes. Lutja është pragu i lirisë, që pakkush e di me siguri se do vijë. Lutja ishte shpresë... Mbese edhe fund. Por, lutja është lutje...

Me konceptin e "Lutjes" do të na vinte më mirë ta identifikonim jo thjesht ekspozitën e fundit të Gazmend Lekës, që qëndron e hapur te FAB prej ditësh, por grishjen që e gjithë shoqëria jonë duhet të bëjë para verdikteve të mëdha. Pasi në këtë çoroditje ka mbetur vetëm lutja për të rivendosur një lloj stadi kundër gjendjes amorfe ku ndodhet vendi ynë. Por ne nuk lutemi. Ne vetëm mallkojmë. Urrejmë. Ankohe mi. Më së shumti shfryjmë.

E gjithë krijimtaria e Lekës, sipas fjalëve të tij, është vetë një Lutje. Ai e bën këtë ritual në çdo moment, derisa të presë momentin e duhur, kur do i duhet të marrë nga genia e tij supreme lejen dhe energjinë e duhur për punë. E tillë është edhe linja e paraqitjes prej 24 punësh e autorit, që është e shpërhapur në tre hapësirat e FAB, ku ndërthuret një narrativë metafizike dhe pikëpamja e autorit që në një farë mënyre na përcjell botën e tij të pafolur para kavaletit, mjedisit dhe të papriturës, që rrethon të gjithë procesin e punës.

E veçanta në të gjitha punët e autorit është se përpara punëve të ekspozuara ke vetë pezullin, që ndërthen krijuesin para fillimit. Është gjendja e autorit para se të mbarë energjinë e nevojshme për të punuar, është momenti i mbarsjes së pafolur. Autori në konceptin e tij e shpjegon lutjen si një akt, që na shoqëron jo thjesht në ditën fizike, por si një akt, që shoqëron gjithçka e cila ndodh në jetë. Kjo e bën ekspozitën, që duhet thënë se është zgjidhur në mënyrë shumë të kursyer pa eksese, për meditime të thella dhe tepër serioze. Ato lidhen me nevojën e ndaljes së gjatë në procesin e meditimt dhe jo vetëm, si edhe kërkesës për të shkuar në hapësirën ekzistenciale, ku njeriu gjen personalitetin e vet të padyzur.

Ky akt murgëror që mund të thotë dikush, është si një paqe e thellë shpirtërore, që zbulon pak a shumë trandjen e madhe të autorit para krijimit, grishjet, por edhe frikërat e mundshme, që shoqërojnë të papriturën në procesin e punës. Disa syresh, zgjidhur në koleksionin e tij të grafikave në mënyrë humoristike nga Goya shekujt më parë. Porse autori ka një mbarsje tjetër dhe kjo lidhet me energjinë e tij të bazës ku ushqehet, të gjithë formimin dhe mbi të gjitha përasiatjen e tij filozofike.

Mbase gjërat nuk shkojnë si duhet,

Me konceptin e "Lutjes" do të na vinte më mirë ta identifikonim jo thjesht ekspozitën e fundit të Gazmend Lekës, që qëndron e hapur te FAB prej ditësh, por grishjen që e gjithë shoqëria jonë duhet të bëjë para verdikteve të mëdha. Pasi në këtë çoroditje ka mbetur vetëm lutja për të rivendosur një lloj stadi kundër gjendjes amorfe ku ndodhet vendi ynë. Por ne nuk lutemi. Ne vetëm mallkojmë. Urrejmë. Ankohe mi. Më së shumti shfryjmë.

"Lutja" e Gazmend Lekës, një grishje për lutje e gjithë shoqërisë



atëherë kur tamam duhet kurse Tela-jot, penelat, tavoloci diku, apo vetë autori që herë gjendet i shtrirë, herë menduar, herë mbi telajot i duhet të gjejë sinergjinë me këtë territor metafizik aspak miqësor. Ajo i ngjet disi momentit, kur zjarri merr jetë nga prekja e elementëve që e shkaktojnë atë. Pikërisht, ky është momenti, kur autori jonë e kërkon fillësën e tij, ndërsa në një rast të kundërt e lëshon atë në funksion të mosbërjes.

Është e vështirë të kuptosh sesa zgjat ky moment, që shoqëron Lutjen, dikush mund të thotë një deqik, një tjetër një kapsallitje syri, një tjetër kohë pa fund, por e gjitha duket se është e lidhur me atë transfigurimin e imazhit, derisa të bëhet e dukshme. Me pak fjalë, kjo ekspozitë është si një autoportret i brendshëm, intim, tejet sekret, i ngjizur në 24 piktura, si 24 copëza të një mozaiku ekzistencial.

Leka e ka konsideruar veprën e tij

gjithnjë si një akt të gjatë lutjeje, që: "... fillon çdo ditë me lindjen e diellit". E shkruar, që në vitin e largët 1994, ajo mbetet ende sot e pandryshuar, si përkufizim dhe udhërrëfyes i njëjës prej krijimtarive më të vrullshme të kohës që jetojmë.

Në rrjedhën e shumë ekspozitave personale: "Black Box", "Kutia e Zezë e Qenies", "Ikarus", "Simbolon", "Molla", "Natura Morta" dhe së fundmi "Taso", lutja, për herë të parë, nuk i drejtohet më një teme të caktuar, porse ofrohet si një vështrim i krijuesit në dimensionin e vet me shpirtëror, zhytur thellë në habitatin e tij, si prifti i lartë i qytetërimeve të para, në kërkim të gjuhës së vjetër, për të vazhduar atë dialog që nisi në gjenëzë të kohës, shkruan kuratori i tij Ermir Hoxha, duke na

futur më institucionalisht në këtë univers. Punët e Gazmend Lekës janë më shumë se "Lutje", janë grishje ku shqiptarët duhet të heshtin dhe të mendojnë para se të akuzojnë dhe bërë gjëra pa sens.

KONCEPTI KURATORIAL

Në heshtjen tonë, ne të gjithë lutemi. Lutemi për shëndetin e trupit e më së shumti, lutemi për shëndetin e shpirtit.

LUTJA është një akt i gjatë që kryhet në vetmi të plotë. Në shurdhërinë e hapësirës, si për të gjithë ne, ashtu dhe për artistin, ajo është kredhja në një dimension tejet personal, ku rregullat dhe arsyja tokësore bëhen të pafuqishme e përthyhen.

LUTJA është akti përgatitor para kryerjes së një riti antik, që ndoshta zë fill që nga muret e errëta të shpellave prehistorike.

LUTJA është akti i murgjive, para pikturimit të ikonave, për t'i bekuar ato me frymë krijimi.

LUTJA është një akt i thellë shpirtëror, para se të ngjizet vepra. Është shpërthim që paraprin mpiksjes e imazhit mbi sipërfaqen e bardhë sterile. Penelat, telajot, tavoloci i stërmunduar... të gjitha janë aty, gati për t'u sakrifikuar.

Ta flasësh e ta përflasësh atë, është gjithnjë e vështirë. Pavarësisht besedave të gjata me artistin, në momentin fundor, logjika të bën të kuptosh, që ajo është një territor metafizik, që nuk duhet prekur, por si pa kuptuar, ajo bëhet e vërtetë për të gjithë ne.

Duket sikur artisti krijon Gjithçka nga Hiçi, pasi krijimin vërtet e paraprin Hesh-tja e Madhe. E gjatë sa një fraksion sekonde, apo sa një përjetësi, artisti dhe objektet që e rrethojnë, humbasin gravitet. Ato ngrihen nga dimensionin tokësor, për t'u rigjetur në një nivel të ri metafizik, ku marrëdhënia me hapësirën dhe hynoren, ngjizen përfundimisht ndryshe.

Kjo ekspozitë i dedikohet kësaj Hesh-tjeje të Madhe. Aty, si në një manifest artistik, pesha e arsyes dhe trupi i artistit, përumben në një perspektivë personale, ndërkohë që studioja kthehet në tempullin e tij vetjak. Ai është aty, i vetëm, me personazhe reale e irreale, me miq e demonë, erën e vajit të linës dhe tingujt e muzikës. Mes rrëmujës së përherëshme, ato ngatërrohen e përzihen njëra me tjetrën. Në mes të kësaj rrëmujë, i përlurur, fanitet imazhi i tij, që endet i vetmuar në studio, i përndjekur shpesh nga imazhi i fundmë i një varri fantazmë, apo nga një hije-kryq "i rastësishëm", gjithë-përshirë në një dimension shpirtëror të thellë, tërësisht i zhveshur nga çdo gjë materiale, si në një rit shamanik, ku qiel-lorja dhe tokësorja bëhen njësh.

Lufta në Kroaci vazhdoi për katër vjet të tëra, kurse gjak pa fund dhe shtëpi të tëra u rrafshuan në tokë. Gjithsesi, Lutja e atyre mbrëmjeve e të gjithë njerëzve, tregoi sesa mund ta bashkojë popullin një akt sublim. "Shqiptarët" kanë nevojë për Lutjen, kurse njerëzit e artit duhet të ndalojnë para "Lutjes"...

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë dhe e paqtë. Themi e paqtë sepse ballinën ia dedikuan Fatos Arapit, poetit të madh shqiptar që ndërroi jetë pak ditë më parë. I ndjeri pothuaj kishte shkëputur lidhjet prej kohësh dhe ishte shumë refuzues ndaj medias dhe kujtdo. Redaktori ishte përpjekur disa herë për një kontakt, por kishte marrë përgjigje negative nga familjarët. Gjithsesi, humbja e tij është e madhe për letrat shqipe dhe është larguar realisht një njeri i njohur për kulturën, që la gjurmë të pashlyeshme në poezinë shqipe. Redaktori bëri një shënim të shkurtër, shtuar me dy foto të Qerim Vrionit, njëra prej të cilave botohej për herë të parë. Zoti Vrioni insistonte që të dilte ky fakt, sikur do ndryshonte diçka për poetin...

Shkrimi kulturologjik ishte i jashtëzakonshëm. Kishte një autorësi treshe dhe shërbente si një ftesë për rizbulimin e Evropës së Vjetër dhe qytetërimit të saj rreth 8000 vjetër në pellgjin Danubian, si dhe vlerat themelore të mishëruara në të. Për herë të parë, erdhi në faqet e "Milosao" një autor kosovar me një poezi interesante, të pasur me një figuracion interesant dhe fabula tepër të ndjera..., shkroi autori për Shaip Beqirin, të cilin ia kish prezantuar një publicist kosovar. Ndrek Gjini në paralelizmin e vet të Lidhjes së Dytë të Prizrenit e kishte tejkaluar

disi, por me sa duket nuk shkëputet nga politika.

Skulptori Emir Grezda, në ditët e fundit, promovoi në Tiranë një përmbledhje artistike në prag të 70-vjetorit të lindjes. Artisti ngulmoi shumë të kishte qasje tjetër, por redaktori nuk mundej. Pak e vështirë të kuptosh përpjekjen, pse një individ do ta tregojë me forcë artin. Zhgënjimi më i madh personal i artistit ishte pse nuk gjeti hapësirë përfshirëse nderimi në Galerinë e Arteve.

Mimoza Kuchly është një nga autoret më të reja, që i shtohet grupit të shkrimtareve, të cilat mëtojnë të shkruajnë për psikologjinë e femrës në kohët tona. Redaktori i shprehu me kujdes rezervat e veta por njëkohësisht edhe e inkurajoi autorin, që jeton jashtë vendit.

Në këtë numër kontribuoi edhe Mira Meksi me një artikull për Artin e përkthimit gojor të Eshref Ymerit, që ajo e kishte vendosur në një rrafsh shumë antik dhe jo vetëm. Redaktori shtoi një shkrim për mikun e tij Arben Meksi dhe Çmimin e fundit, që atij iu akordua në 7 tetor, në Kirenia të Qipros nga Juria e konkursit Ndërkombëtar të Karikaturës Ndërkombëtare.

Numri kishte vërtetë shumë emra dhe mbi të gjitha cilësi të mirë. Edhe layout e zgjidhi mirë detyrën e vet, kryesisht atë që lidhej me shkrimin kulturologjik.

P

PONTIFIKATI



NGA KAROL BACHURA*

Viti 2018 përkon me 25 vjetorin e vizitës së parë apostolike në histori të Atit të Shenjtë Gjon Pali II në Shqipëri si dhe viti i 40 vjetorit të zgjedhjes së Polakut, kardinalit Karol Wojtilla (Karol Ćojty'a) në Selinë e Shenjtë. Papës së parë jo-italian në më shumë se pesë shekuj.

Më 22 tetor bëhen plot 40 vjet nga inaugurimi i Pontifikatit të Gjon Palit II, të cilit i ndriste udhën deviza "Totus Tuus" - jam i gjithi Yti, Mari. Ky qëndrim i Shenjtit Gjon Pali II na ka mësuar jo vetëm neve, besimtarëve të kishës katolike-romane, por edhe më gjerë. I ka mësuar gjithë njerëzimin si të fal, si të dialogojë me përfaqësuesit e besimeve të tjera, si të dojë të afërmin, por edhe si të largohet nga kjo botë.

Në Homilinë e ditës së inaugurimit të Pontifikatit, 22 tetor 1978, shenjtji Gjon Pali II bëri thirrje për të mposhtur frikën: "Mos u frikësoni. Hapjani, hapjani dyert Krishtit. Hapjani dyert pushtetit të tij shpëtues, hapini kufijtë e shteteve, regjimeve ekonomike dhe politike, fushave të gjera të kulturës, qytetërimit, zhvillimit". Ky mesazh është aktual sot e gjithë ditën, edhe në raport me shqiptarët, që të mos u frigoheh sfidave, të mos trembe nga reformat, të mos i frikësohen të ardhmes.

Evropa dhe integrimi i saj kanë qenë me siguri një nga shqetësimet parësore të Gjon Palit II, çka e dëshmoi në gjithë pontifikatin e vet. Ai ka qenë i bindur se dy mushkëritë e Evropës, lindorja dhe perëndimorja, i janë asaj të domosdoshme për të qenë një Evropë e plotëuar.

Për Gjon Palin II thelbin e konceptit Evropë nuk e përcaktonte kufijtë e saj geografikë. Element i qenësishëm i identitetit të saj - ka qenë dhe mbetet kultura. "Sepse historia e Evropës është si ai lumi i madh, tek i cili derdhen shumë degëzime dhe përrën, ndërsa laryshmëria e traditave dhe kulturave që përmban janë një thesar i madh i saj" - ka thënë Gjon Pali II në GnieŹno në vitin 1997.

Ndaj sot, në pritje të vendimit vitin tjetër të Këshillit Europian mbi çeljen e mundshme të negociatave me Shqipërinë, po i lejoj vetes të parafrazoj disa fjalë të shenjtit



Në kujtim të Atit të Shenjtë, Gjon Pali II

Gjon Pali II që edhe sot Evropa që të mund të mbushet plotësisht me frymë ka nevojë për të dyja mushkëritë - mushkëritë e BE-së dhe mushkëritë e Ballkanit Perëndimor, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e idesë së bashkimit të kontinentit. Dhe bash këtu bëj një pyetje retorike - A do të ishte vallë e plotë kultura evropiane pa kulturën e pranishme në trojet e Shqipërisë së sotme, e kësaj kulture që vjen nga kohërat parahomerike, apo mbretërisë ilire?

Personalisht nuk kam për ta harruar kurrë 16 tetorin e vitit 1978, kur disa minuta para orës 19:00 mbarë bota mësoi se ishte zgjedhur papa i ri - një papë nga një vend i largët, një papë polak, papë nga përtej perdes së hekurt. Në Poloni qarkullon një anegdote, sipas së cilës, kur njëri nga udhëheqësit e byrosë politike të partisë punetore të bashkuar polake kishte mësuar mbi zgjedhjen papë të kardinalit Wojtilla, pat bërë thirrje "O Zot!" - kesi ateistësh kemi pasur në Poloni. Ndërsa mua më janë ngulitur thellë fjalët e babait tim, që më 15 tetor 1978, për habi të ballarëve të kombit nuk e përjashtonte mundësinë e zgjedhjes papë të ndonjë polaku. Pas konfirmimit të parandjenave të tij, një ditë më pas, pikërisht në datën 16 tetor 1978 babai konstatonte se ajo ditë, dita e zgjedhjes së

Wojtillës në selinë e shenjtë kishte për të qenë "fillimi i fundit të komunizmit". Historia i dha të drejtë.

Kur në vitin 1979 papa Gjon Pali II vizitoi Poloninë, në Varshavë tha disa fjalë që shenjau nisjen e çmontimit të murit të Berlinit dhe zgjedhës komuniste. "Thërras, unë, biri i tokës polake, njehëresh unë, Gjon Pali II, papa. Thërras nga thellësia e këtij Mijëvjeçari, thërras në vigjilje të Festës së Predikimit, thërras bashkë me ju të gjithë Jepini liri shpirtit, jepini liri shpirtit dhe ndërrojani fytyrën tokës. Kësaj toke". dhe e çliroi. Polakët nisën të ndiejnë bashkësinë si kurrë më parë. Një vit më vonë lindi lëvizja "Solidaritet" që grumbulloi rreth vetes 10 mln njerëz të punës në popullsinë 30 milionëshe të vendit, shtypur nga gjendja e luftës dhe që përgjatë një dekade po e gërryente totalitarizmin komunist, të rënë përfundimisht në 4 qershor 1989. Duhet kohë dhe një reflektim i thellë, por edhe distancim historik, për të kuptuar ndikimin e jashtëzakonshëm të shenjtit Gjon Pali II mbi fatet e botës, në reformimin e kishës dhe jetësimin e vendimeve të Konciliumit II të Vatikanit mbi zgjerimin e frymës së ekumenizmit dhe Dashurisë Hyjnore që fle në secilin prej nesh.

Në prill 1993 kur Gjon Pali II - si papa i parë në histori erdhi në Tiranë dhe Shkodër artikuloi disa fjalë: "Vëllezër dhe

PISHËS POLAKE

NGA KAROL VOJTILLA (GJON PALI II)*

Ajje ku vreshtat, portokallat eremira hedhin shtat, Ti e thjeshta ime shtëpiake, o pishë e Zakopanes Shkeputur nga i nënës dhe motrave dhe Qendron mes kopshtit të huaj jetime.

Ah sa mik i dashur je bërë për syrin tim, Ngase të dy vuajmë të njëjtin denim, Pelegrinazhi edhe mua larg më çon, Jeta edhe mua në dhë të huaj po m'kalon.

Megjithë mundin e të ljerëve përrelh, Fuqi perse humbet, shtat perse nuk hedh? Këtu diellin dhe vesën pranverore më herët i ke, Ndërsa degët të lëshohen zbehte per dhe.

Vyshkesh. Thahesh tristhueshëm në horizontin lulezues Nuk ke jetë, sepse Atdhe nuk ke. O dru besnik!

Dëbimin, përballimin dot s'e përballon Në vjeshtë dhe dimër moli i keq po afron Dhe do të biesh e vdekur! Toka e huaj do të përthilhe. Me thuj, O e imja peme, Me i lumtur se ty valle do të jem?

*Përktheu Astrit Beqiri

motra shqiptarë. Ju përshëndes me gjithë zemër, Fort të dashur: Zoti mbroftë atdheun tuaj. Zoti mbroftë popullin shqiptar kudo në botë. Në emër të Zotit ju përqafoj të gjithëve dhe ju bekoj".

Por nuk ishte ky rast i vetëm kur papa Gjon Pali II u adresojë shqiptarëve. Ishte i vetëdijshëm për shtypjen e regjimit të Hoxhës. Është i njohur botërisht qëndrimi i Tij ndaj figurës së Nënë Terezës dhe udhëheqja e procesit të beatifikimit të saj gjatë pontifikatit të Tij. Sidoqoftë në fillim të viteve '80 shenjtji Gjon Pali II kishte për të thënë: "Pas popullit polak më shumë dua popullin shqiptar; dhe kjo për dy arsye: së pari për shkak se shqiptarët kanë vuajtur për një kohë shumë të gjatë, shumë padrejtësisht, dhe së dyti ngaqë i kanë dhënë botës Nënë Terezën e Kalkutës".

Me siguri që kjo është një nga arsyet pse kisha në Bathore është e para në botë me emrin e shenjtit Gjon Pali II - e shuguruar gjashtë ditë pas kanonizimit të Gjon Palit II. Jo në Poloni, jo në Itali, apo gjetkë në botë, por bash këtu, në Shqipëri. Po këtu, në Shqipëri, vullnetarët nga kishëza lokale arritën të përgatitnin dhe vinin në skenë këtë vit në Tiranë, me thjeshtësinë dhe sinqeritetin e tyre, musical mbi jetën e Karol Wojtillës - Gjon Palit II me titull "Lolek".

Si polak kam pasur fatin të takohem personalisht me shenjtin Gjon Pali II në vitin 1986, në rezidencën verore papale, në Castel Gondolfo, në Itali. Kjo audiencë, bashkë me përfaqësues të komunitetit polak, ka lënë gjurmë të thellë në jetën time dhe është kthyer në një dritë që qartëson qoftë edhe terrin më të llalltarshëm.

*Ambasador i Republikës së Polonisë

Opinion

i Ditës

Në një jubile të veçantë shqiptaro – gjerman

Nga Dr. Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

...e Teknik. Ka disa arsye që e bëjnë atë një jubile krejt të veçantë; në radhë të parë, sepse ndonëse ende nën diktaturë, ajo ishte marrëveshja e parë ekonomike me një vend perëndimor e aq më tepër si Gjermania Federale. Po, kishim pasur bashkëpunim dhe më parë, por ai ishte thjesht tregtar, pa investime dhe aspekte të tjera si kreditë/ndihmat të një bashkëpunimi të vërtetë ekonomik.

Gjithashtu, nënshkrimi i asaj marrëveshjeje ishte me jehonë pas qëndrimeve të ngurta dhe refraktare të regjimit të asaj kohe. Me gjithë vështirësitë në rritje, rënien e nivelit të jetesës, të ekonomisë e të eksporteve, mungesave të mëdha në treg dhe për mallrat më jetike, vazhonte avazi i vjetër se «bar do të hamë, por parimet nuk i shkelim».

Edhe pse me mungesa dhe jo në formatin e saj të plotë, sepse për shkak të Kushtetutës socialiste, bashkëpunimi industrial, kreditë dhe format e tjera të financimit ndërkombëtar ishin ende tradhti e lartë, ajo shërbeu si model dhe nxitje për marrëveshje me vende të tjera perëndimore.

Në të tilla përvjetorë zakonisht përmenden shifra, bilance investimesh, volume tregtare, etj. Natyrisht statistikant kanë rëndësinë e tyre, si mishërimi dhe konkretizimi i këtyre marrëveshjeve historike dhe dinamikës dypalëshe. Për më tepër se Gjermania dallohet jo thjesht si donatori më i madh për vendin tonë në planin dy dhe shumëpalësh, por mbi të gjitha nga katalogu i larmishëm dhe cilësia e ndihmave. Veç kësaj, rezultatet e bashkëpunimit me Gjermaninë janë të dukshme, të kapshme dhe të prekshme për çdo njeri dhe vizitorët e huaj në vendin tonë. Sepse programet/projektet e shumta gjermane janë orientuar dhe përqendruar në fushat jetike të zhvillimit afat-gjatë ekonomik dhe social: turizmi, mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit, me theks të veçantë i liqeneve të Shkodrës dhe Ohrit, ndërtimi i linjave të tensionit të lartë, i ujësjellësve në shumë qarqe, etj.

Por, krahas volumeve dhe shifrave, ky jubile përbën rastin më të mirë që të kujtojmë me nderim dhe respekt ata personalitete dhe ekspertë që kontribuan për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, për jetësimin e projekteve të bashkëpunimit deri në ditët e sotme, duke sfiduar pengesa dhe vështirësi të mëdha politike, ekonomike dhe sidomos sistemit politik në rastin tonë.



Duke qenë se gjatë gjithë viteve 80 isha ekspert në tregtisë së jashtme, me shërbime pune në Gjermani dhe në fillim të viteve 2000 diplomat në ambasaden tonë në Berlin, shumë prej tyre dhe proceset që drejtuan/realizuan në vijim kam pasur shumë raste t'i njoh dhe shoqëroj nga afër.

Padyshim që «pionieri» i këtij bashkëpunimi dhe miqësie me Gjermaninë ishte legjendari bavarez Franz Joseph Strauss; i pari politikan perëndimor i këtij kalibri që erdhi në Shqipëri më 1984. Ndonëse për vizitë private, Strauss u dashurua shumë shpejt me popullin dhe vendin tonë; erdhi dhe dy herë të tjera, në përpjekje për ta afruar Shqipërinë me Bavarinë, këtë «urë» të madhe drejt Ballkanit, Gjermaninë dhe Evropën. Vdekja e tij e papritur 30 vite më parë, vetëm tre javë përpara nënshkrimit të Marrëveshjes, për të cilën ai kontriboi më shumë se kushdo tjetër nuk e lejoji që «shansin e humbur» të atyre tri vizitave historike ta kthente në një «mision të mundur», siç u bë më vonë.

Drejtuesit e delegacioneve gjermane në bisedimet për këtë marrëveshje ishin zoti Erich Riedl, Sekretari Parlamentar i Ekonomisë dhe Financave në periudhën 1987-1993, deputet veteran i Bundestagut dhe dashamirës i vendit tonë që u nda nga jeta këtë shtator. Po ashtu, sekretari i Shtetit në Ministrinë e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar Sigfried Lengl, bashkëpunëtor i ngushtë i Strauss. Këta dy emra ishin ndër më të lakuarit gjatë atyre viteve falë vizitave në Tiranë. Bon dhe

Mynih.

Disa vite më pas, punën e tyre e vazhdoi Rezzo Schlauch, personalitet i njohur i të Gjelbërve gjermanë, deputet i Bundestagut dhe në vitet 1998-2005, Sekretar Federal i Shtetit për Ekonominë. Falë dhe bashkëjetesës me një bashkëatdhetare të njohur, ai u «shqiptarizuar» shumë shpejt. Të gjithë në atë superministri e vlerësonin këtë fakt dhe sa herë shkonim për punë aty, dyert hapeshin menjëherë me simpati. Prej disa vitesh, është Konsulli ynë i Nderit në Stuttgart.

Këta drejtues patën dhe bashkëpunëtorë kompetentë e dashamirës të vendit tonë që vijojnë me përkushtim deri në ditët e sotme. Ndër më tipikët është drejtori për vendet e Ballkanit dhe Shqipërinë qysh nga viti 2001 e në vijim në Ministrinë Federale të Ekonomisë dhe Financave, zoti Helge Tolksdorf.

Nga pala jonë këtë proces dhe bisedimet e gjata i kryesoi qysh nga fillimi me kompetencë e ndjeri Farudin Hoxha, ish-Ministër Shteti për Bashkëpunimin ndërkombëtar, pasi kishte lënë postin e ministrit të Ndërtimit. Qytetar dhe personalitet rrezatues dhe reformator, me integritet moral absolut, njeri që të nderonte kudo me kulturën dhe xhentesën e tij, projektuesi i talentuar dhe i palodhur i gjigandëve tanë hidroenergetike. Kush i ka ndjekur tratativat dhe bisedimet gjatë atyre viteve të vështira, me gjithë hapjen «me frëngji» e ka parë se sa mund, zell, pasion, guxim, kurajë dhe vendosmëri politike ka shfaqur profesori i nderuar, padyshim ndër pro-

motorët e miqësisë dhe bashkëpunimit shqiptaro-gjerman.

Ai kishte dhe një staf bashkëpunëtorësh specialistë të përgatitur dhe reformatorë, që e njihnin mirë funksionimin e ekonomisë perëndimore. Shumica e tyre e lanë vendin si pasojë e persekutimit të ri politik dhe punojnë në institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare. Ndenji këtu mes shumë peripetish Dr. Ylli Çabiri, kryeordinator i asaj ministrie, i specializuar në Francë. Në vitin 1991 u përfshi në kabinetin qeveritar, për ta larguar pas rënies së tij në dhjetor 1992. Ka mbi 20 vjet që ka punon në projekte të shumta ndërkombëtare, të BE-së dhe në Fondi Shqiptaro-Amerikan i Sipërmarrjes. Rol të dukshëm luajti Ministria e Jashtme dhe Ish-zëvendësministri, i ndjeri Sokrat Plaka, i cili mbulonte fushën e ekonomisë dhe tregtisë së jashtme.

Padyshim që ambasada gjermane në Tiranë dhe sidomos ambasada jonë e sapohapur në Bon gjatë asaj periudhe kanë përballuar një peshë të madhe në të gjitha aspektet. Kjo dhe falë ambasadorit të shquar të karrierës të asaj periudhe dhe deri ditët e sotme, Shpëtim Çausi; ai ishte mjaft aktiv në atë periudhë tejet të ngjeshur mesazhesh, kontaktesh dhe pengesash se bashku me stafin e tij dhe këshilltarin tregtar, Pajtim Ajazi, ndër kuadrot më të aftë të asaj periudhë dhe ish-zv.ministër i Tregtisë së Jashtme.

E para që ka luajtur rolin e vet të pazëvendësueshëm qysh në ditën e parë të këtij procesi 30-

vjeçar e në vazhdim është Shoqata e Bashkëpunimit Teknik Ndërkombëtar Gjerman GIZ ose GTZ e dikurshme. Nuk ka pasur dhe nuk ka projekt madhor që të mos ketë kaluar në të gjitha etapet në duart dhe kompetencën e saj për të cilën është folur e do të flitet aq shumë. Po ashtu, Dhoma e Përbashkët e Tregtisë shqiptaro-gjermane (DIHA), e krijuar më 2007, shoqata afariste, etj.

Në këtë katalog të larmishëm ka vendin e saj dhe Shoqata e Bashkëpunimit Ekonomik Gjermano-Shqiptar (DAW)

Gjatë 24 viteve DAW është afirmuar si model bashkëpunimi, që i kalon caqet ekonomike apo afariste. Gjysma e kryesisë së saj përbëhet nga shtetas shqiptarë me banim në Gjermani që kanë mbi 15 vite që janë aktivë si Majlinda Çaçi që është dhe zv.presidente, Anette Wolter, Kolë Gjoka, Artan Pojani e të tjerë. Një ndër të parët është shqiptari nga Tetova, afaristi Amit Ismailji, model i imazhit të shqiptarëve dhe një prej nxitësve të kësaj miqësie dhe bashkëpunimi.

Nga nëntori 2005, president i saj është një profesionist veteran i komunitetit të madh afarist gjerman, Prof. Dr. Hans-Jürgen Müller; bashkë me institucionet e tjera përkatëse, ai ka kontribuar mjaft në veprimtaritë zyrtare dhe publike, e sidomos në takimet dhe forumet e biznesit të organizuara gjatë tri viteve të fundit, me rastin e vizitave zyrtare të kryeministrit, të ministrave e zyrtarëve të tjerë të lartë qeveritarë në Berlin dhe gjetkë. Me propozim të ambasadës sonë në Berlin, në vitin 2015, Presidenti i Republikës e dekoroi me medaljen për shërbime të shquara civile. Në krah të tij janë dy zv.presidentët, Thomas Wittstadt dhe Helmut Hauser, anëtar i kryesisë dhe bashkëthemelues Peter Spary e të tjerë.

Gjithsesi, «motori» i kësaj shoqate, drejtuesi i saj i vërtetë operativ ka qenë dhe mbetet Michael Albert. Krahas detyrës së tij si administrator kompetent në Konfederatën e Tregtisë Gjermane, Michaeli është ndër personat më të interesuar e gjithnjë në kërkim të nxitjes së këtij bashkëpunimi.

Natyrisht në këtë fushë kanë ndikimin e tyre të madh drejtuesit e lartë dhe ekspertët e firmave dhe kompanive gjermane të angazhuara në vendin tonë dhe gjigande si Siemens apo Hochtief që ndërtoi Aeroportin e Rinasit. Më tej, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, edhe pse mundësitë kanë qenë më të shumta.

Në këtë 30 vjetor, sfidat dhe kërkesat janë shumë më të mëdha. Ndaj, përvoja, vullneti politik i treguar nga të dyja vendet, përpjekjetimi i integritimit tonë evropian etj., me siguri që janë udhërrëfyes më i mirë për pasurimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën ekonomike, tregtare dhe të investimeve ndërmjet dy vendeve tona aleate.

Së fundi, «qershiza mbi tortën» në prag të këtij jubileu festiv ishte njoftimi i ambasadores gjermane në Tiranë, Suzanne Schütz se në nëntor Gjermania do lançojë një program tjetër të madh ndihmash dhe bashkëpunimi për vendin tonë. Ndaj me plot gojë dhe me zë të lartë shprehim mirënjohjen tonë «Danke Deutschland»

Opinion i Ditës

Komisioni i BE: përgatitje për zgjedhjet europiane

Nga Barbara Wesel

(vijon nga faqja 1)

... është shumë herët për të folur: cilët janë kandidatët?

MANFRED WEBER: I PËRSHTATURI

Njeriu i CSU-së i takon kraut të moderuar, gjithsesi atij me qëndrim miqësor ndaj Europës të partisë së tij. Prej vitit 2004 ndodhet ai në Parlamentin Europian dhe që prej katër vjetësh është kryetar i grupit më të madh parlamentar, i Partisë Popullore Evropiane. Atje ai ka shërbyer para së gjithash si organizator në prapaskenë, i cili është në gjendje të organizojë shumica. Për këtë shkak, një sërë partish anëtare kanë premtuar se do ta mbështesin.

Ajo që e demton Weberin është se për vite të tëra ai i ka ofruar mbrojtje në grupin e tij parlamentar partisë Fidesz të antidemokratit praktikues Viktor Orban. Vetëm që kur paraqiti kandidaturën, Weberi është distancuar prej tij.

Veç kësaj bavarezit i mungon forca tërheqëse. Anglishten që flet ai mund ta quash me vështirësi mesatare dhe kozmopolitizmi nuk është ana e fortë e tij. Para së gjithash Weberin i mungon çdo përvojë qeverisjeje. Me sloganin e tij për zgjedhjet "T'ua kthejmë Europën njerëzve" ai do ta ketë të vështirë të tërheqë masat që të mblihdhen në sheshet e tregjeve në vendet fqinje.

ALEXANDER STUBB: PËRTËRITËSI

F'inlandezi që lë përshtypjen e një djali të ri është si të thuash e kundërta e Weberit. Ai e nisi si eurodeputet, mbajti postaj poste të ndryshme ministore në Helsinki dhe ishte për një kohë të shkurtër kryeministër i vendit të tij. Ai ka studiuar në shkollën me emër të Londrës LSE dhe bën pjesë më tepër të tipat e "elitës globale". Krahas anglishtes perfekte ai flet mirë frëngjisht dhe tani po bën një turne me shtypin në BE. Bën pjesë në krahun liberal të partisë së tij konservatore të atdheut. Me sloganin e tij "Next Generation Europe" ai mund të tërheqë shumë vëmendje. Revolucionin digjital, ndryshimin e klimës dhe pajtimin social ai i ka në qendër të fushatës së tij dhe përfaqëson ndryshimin e brezave, me të cilin ai synon ta rigjallërojë BE.

FRANS TIMMERMANS: LUFTËTARI

Nga socialdemokratët kandidon zëvendës-presidenti i BE Frans Timmermans. Holandezi bir i një diplomati flet rrjedhshëm pesë gjuhë dhe ka përvojë të mad-



he në parketet diplomatike. Ai ka qenë ndër të tjera ministër i Jashtëm i Holandës. Pozicionet e tij ai mund t'i mbrojë në çdo podium diskutimi dhe në çdo studio televizive të Europës.

Kohët e fundit, Timmermans i zhvilloi para së gjithash konfliktin me Poloninë për shkak të problemeve me shtetin juridik,

duke treguar papërkulshmëri të madhe. Ai është një luftëtar pararojë i bindur për vlerat e BE dhe një evropian pasionant.

MARGRETHE VESTAGER: E CIVILIZUARA

Komisarja daneze për konkurrencën konsiderohet deri tani jozyrtarisht si kandidatja kryesore e liberalëve evropianë. Ajo

është e re dhe energjike dhe nuk ka frikë që të matet me konkurrentin e mëdha të kësaj bote, që nga Google te Facebook. Në atdheun e saj ajo ka qenë kryetare partie dhe ka mbajtur disa poste ministrore. Ajo do të ishte padyshim mobilizuese në fushatën elektorale evropiane, sepse thaujse askush nuk i përcjell në mënyrë kaq të besueshme dhe të afërta për njerëzit mesazhet sa danezja.

MATTEO SALVINI: SHKATËRRUESI

Ekstremisti i djathtë italian sapa u propozua nga AfD gjermane si kandidat i përshatshëm kryesor për populistët e djathtë të Evropës. Salvini do të mendohet ende nëse do të kandidojë vërtet për Komisionin e BE. Javën e kaluar, shefi i Legas u takua me Marine Le Pen e Front National dhe të dy i deklaruan kryetarët e qeverive të BE si "armiqtë të Europës".

Veç kësaj bavarezit i mungon forca tërheqëse. Anglishten që flet ai mund ta quash me vështirësi mesatare dhe kozmopolitizmi nuk është ana e fortë e tij. Para së gjithash Weberin i mungon çdo përvojë qeverisjeje. Me sloganin e tij për zgjedhjet "T'ua kthejmë Europën njerëzve" ai do ta ketë të vështirë të tërheqë masat që të mblihdhen në sheshet e tregjeve në vendet fqinje.

HOROSKOPI

DASHI

Shmangni konfliktet pasi mund të ndikojnë negativisht në shëndetin tuaj. Mund ta gjeni veten në një situatë shumë emocionuese. Natyra juaj e gëzë do të gëzojë njerëzit rreth jush.

DEMI

Keqkuptimi mes jush dhe një mikut tuaj mund të sjellë një situatë të pakëndshme. Do të keni dëshirë të shpenzoni para dhe të argëtoheni, por bëni kujdes pasi do të pendoheni nëse dilni jashtë buxhetit tuaj.

BINJAKET

Motivoheni veten për të qenë më optimistë. Kjo do t'ju risë besimin në vetvetë dhe fleksibilitetin. Progresi i ngadalë në punë do t'ju shkaktojë pak tension. Sa i përket jetës martesore, do të kaloni momente fantastike.

GAFORJA

Do të keni kohë mjaftueshëm për t'u relaksuar. Gjatë ditës së sotme do të keni mundësi të përfundoni edhe disa detyra, të cilat keni kohë që i keni lënë pezull. Besimi në vetvetë do të jetë i lartë dhe performanca juaj në punë do të jetë më e mirë se ç'prisnit.

LUANI

Në mbremje do të përjetoni një situatë që do t'ju mbajë paksa të tensionuar, por mos u shqetësoni pasi do të kalojë shumë shpejt. Gjendja financiare do t'ju rritet, teksa do të keni disa fitime të papritura.

VIrgjeresha

Bëni më shumë kërkime në skemat që iu janë propozuar për të investuar. Një lajm i mirë i papritur nga disa të afërm të largët do t'ju lumturtojë ju dhe familjen tuaj. Partneri-partnerja do të jetë entuziast për planet tuaja të reja.

PESHORJA

Bëni kujdes me dietën dhe kontrolloni peshën tuaj. Ka gjasa t'ju realizohet një dëshirë, të cilën keni kohë që e prisni. Puna juaj do të vlerësohet dhe do të sjellë rezultate. Kontrollit fjalët pasi mund të lëndoni prindërit. Idetë e reja do të jenë produktive.

AKREPI

Diferencat në mendime mund të shkaktojnë irritim për ju. Ka gjasa që sot të takoheni një person, të cili e shihni rrallë. Do të jeni në qendër të vëmendjes gjatë ditës së sotme, teksa dikush do t'ju shpreh mirënjohjen për ndihmën që i keni dhënë.

SHIGJETARI

Përpikuni t'i zgjidhni konfliktet, në mënyrë që të ndihni të qetë. Fëmijët do t'ju bëjnë të ndihni krenarë me arritjet e tyre. Mund t'ju prishen planet pasi ka gjasa t'ju vijë një mik që nuk e prisnit.

BRICJAPI

Personat e kësaj shenje që vuajnë nga tensioni duhet të bëjnë kujdes. Rritja e të ardhurave do t'ju çojë drejt disa blerje të rëndësishme. Mos i ndani me të tjerët çështjet tuaja personale. Sot do të ndjeni mungesën e partnerit/partneres suaj.


UJORI

Do të ndiheni shumë energjik gjatë ditës së sotme. Mund të përfshihen nga disa mendime romantike, të cilat do t'ju bëjnë të ndiheni mjaft mirë. Mos i bëni kurioz të tjerët që të pyesin sesi ndiheni.

PESHQIT

Ka gjasa të tensionoheni për shkak të një debati në shtëpi. Megjithatë, në pjesën tjetër të ditë do të kaloni momente të këndshme duke u argëtuar me fëmijët tuaj. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

Fjalëkryqi (1)



38. Fillojnë vonë.
39. Krijoi James Bond.
40. Ishulli i Odiseut.
42. Van der portier.
43. Një karamelle aromatike.
44. Mund të shkojnë... nga frika.
- VERTIKAL**
1. Bëhet duke vënë në lojë.
2. Pak origjinale.
3. Thahet me bonifikim
4. Në fund djathtas.
5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
7. Hidhet një për shesh.
9. Kokëkuqja në pit stop.
10. I famshëm ai i Sizifit.
12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
13. Një diktator shtypës

- VERTIKAL**
1. Të çara ato të Shollohov.
5. Fillojë luftën.
6. Liszt kompozitor.
8. Marsi në Areopag.
9. Kështu fillon filmi.
11. Gjysmë linear.
12. Një freskues në tavan.
18. Eshhtë gazeta Panorama.
20. Mund të jenë kamikaze.
21. Masat pa kufij
23. Venier e spektaklit italian.
25. Sophia e kinemasë.
26. Safin tenist.
29. Eshhtë makut, i pangopur.
31. Eshhtë faqe ene.
32. Një kafshë që hap... galeri.
33. Një fytyrë e keqe.
35. Preken nga sindroma Basedow.
37. Italia në Internet.


14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
15. I kanë çift radhët.
16. Janë llahtarë.
17. Poeti kur nuk pi.
19. Fillojnë periudhën.
22. Omar që që aktor.
24. Si sezonale.
25. Janë banorët në Riga.
26. Carey këngëtare.
27. Nuk i tregohën babait.
28. Bëjnë arte me re.
29. Kush ka... e ka humber toruan.
30. Një stacion orbital.
31. Fillojnë profesionin.
33. Gibernau i MotoGp.
34. I kanë të ndryshme tutat
36. Gjysmë ditari.
38. Varet me re.
41. Kufijtë e kujtesës.
42. Sapo fillonjë.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
1. Gustav kompozitor.
6. Në krye të kryesisë.
7. Lexohet në pentagram.
11. Sastre aktore.
12. Gjysmë akordi.
15. Dhjetë angleze.
16. Satira për zë.
18. Eshhtë situata e tensionuar.
21. Pak teatrale.
22. Bëhet me mea culpa.
24. Fundi i një samurai.
25. Mbeten në fund.
26. Lind në kokë.
28. Në radhë të parë.
29. Iniciale e Camus
30. Një verë në Paris.
31. Partizani i vogël... në një film tonin.
33. Litra pa kufij.
35. Eshhtë fatë.

36. Një pjesë e kinematografisë.
37. Një pjesë e akademisë.
39. Kufijtë e tretjes.
40. Mbyll të çarën.
41. Erik çiklist.
43. Një pjesë e medaljes.
44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës
51. Mbyllin një spital.
52. Mbyllet me dorëzë.
53. Ishin kalorësi si Rolandi
54. Ndalo në... kryqëzim.


- VERTIKAL**
1. Janë enigmatikë.
2. Mund të jenë parabolike.
3. Ishte xhelozia e Olimpiti.
4. Kufijtë e lëvizjes.
5. Fillojnë radhitjen.
6. Janë kushte.
8. Totem pa ekstreme.
9. Mbyllin kanate.
10. Shoqëronte Edipin e verbër.
13. Eshhtë gjeli.
14. Moore aktore.
17. Janë forcat e Reneas.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin dritaren.
26. Fillojnë matjet.
27. Duhet ruajtur.
32. I bën një serenatë Rosina-s.
34. Gjysmë rabini
38. Mustafa.. Atatürk.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Ai i muzave është Helikona.
45. Një pjesë e gadishullit
47. Muzika e Eminem.
49. Fillojnë operacionin.
50. Kapen të parat.
52. Kufijtë e drejtëzës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	6		9	8					
		3							1
					7		8		
	3					1	7		
	5	6					9	4	
7		1	2			3		5	
		5			2		4		
9	7	2			8				
				9	6				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	3	9	6	7	1	5	8	2
1	7	8	2	3	5	9	4	6
5	2	6	8	4	9	3	1	7
7	4	5	1	8	6	2	3	9
6	1	2	7	9	3	4	5	8
8	9	3	5	2	4	6	7	1
9	5	1	3	6	8	7	2	4
2	8	4	9	5	7	1	6	3
3	6	7	4	1	2	8	9	5

Argëtim filozofik

- Njeriu e vë veten në nivelin më të cilin të tjerët e vlerësojnë.
- Një jetë e padobishme është një vdekje e hershme.
- Moshë na tregon ne sa fëmijë kemi mbetur.
- Të gjitha mendimet inteligjente janë menduar tashmë; e vetmja gjë e nevojshme është të përpiqemi t'i mendojmë prapë.
- Dijet që kam unë mund t'i ketë çdo njeri, por zemra ime është vetëm e imja.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

12	6	10	2		15	10		15	1	11
1	9	3	7		8		2	7	16	11
4	1	10		5	3	9	3	8	2	12
2	9		16	6	4	2	8	6	9	2
18		12	1	15	2	8	1	11	2	7
6		11	1	15	9	1	8		1	8
4	3	1		3	8		11	16	8	2
2		7	9	3	2	4	3	8	2	16
	15	2	7							
7	3	12	9	3	8		11		17	6
1	11	3		11	6	4	10	9	1	9
8	3	8		1	18	10	3	9	1	3

- Bukuria është manifestim i ligjeve sekrete natyrore, të cilat përdryshë do të na fshiheshin në përgjithmori.
- Të jesh brilant nuk ka asnjë vlerë, nëse ti nuk respekton asgjë.

Thënie të mençura

- Sundoje atë! Bëje botën t'i shërbejë qëllimit tënd, por mos i shërbe asaj.
- Tregohu i njerëzishëm dhe përdor fjalë të mira, sidomos për ata që nuk janë të pranishëm.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K	
A	D	E	L	A	N	T	I	K	E	O	L
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E
				K	E	N	E	T	A	O	R
P	A	U	L	I	N	R	A	R	I		
A	K	E	O	T	A	A	D	D	I	M	
R	E	U	M	U	N	E	K	I	E	R	A
E	T	J	I	T	E	R	I	A	M	A	N
I	N	T	E	I	G	O	R	D	I	A	N
I	N	T	A	R	O	M	A	T	I	T	I
P	A	B	M	E	L	E	R	G	O		
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T
S	T	A	D	I	T	M	E	T	A	M	A
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V	
K	A	T	I	A	S	I	E	E	S	E	
A	R	N	I	O	L	A	I	R			
M	A	S	S	I	M	O	Z	A	N	O	R
A	M	A	N	A	N	N	A	N	N		
T	T	E	R	R	E	N	T	E	I	N	E

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

